

EQREM ÇABEJ

STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XIV

M.

magár *margác*, mird. *magjár* m. "gomar"; fem. *magare*; *bar magari* "Petasites Dörfleri" (Rr. Zojzi, Leka IX 261 vv.). Sot fjalë e geg. veriore e verilindore. Përdoret dhe për "demiroxhak", ashtu si sinonimi *gomar*. G. Meyeri 253 e afron me serbokr. *magarac* "gomar" *magarica* "gomare" *magare* "kriç", bullg. *magare* "gomar", rum. *magar* "gomar", dhe mendon — me dyshim — për një metatezë nga *gomar*. Kështu më parë dhe Miklosichi (Slav. Et. im Rum. 29), Cihac II 180. F. Konitza (Albania VIII, 1904, Ser. 9, f. 52) formën *margaç* e nxjerr nga lat. popullore *marcatum* për *mercatum* "treg". Për Oştirin (Don. nat. Schrijnen 266 vv.) fjalë e zërtëhyeshme në *ma-gar* dhe e krahasueshme me dak. *ἀναγοσεξέ. όνοβουγς*, kjo mbase e emendueshme në *ἀναγο-σεξέ*, po sh. Jokl IJ XV VII 167. Pas Iljinskít (Rodna reč 7,9 v.) bullg. serbokr. *magare* paskan dalë prej rrënjës *mek-meg-* "blegërij, vërras". Te mendimi i një metateze nga *gomar* kthehet Mladenovi 289.

Ndërsa Buzuku ka *ager*, Bardhi jep *Asinus Margaç* e *Gomar*, *Asininus Margaçth*, *Bogdani* (I 153, 5; II 110, 10) e *ngarkuem mbë magarët, e mbë zog të magaresë* "et ascendens super asinum, et super pullum filium asinae"; *qi magarthi përmbi të sillët aj ish hipunë, të shkelënte përmbi petëkatë tyne* "che l'asinello, sopra quall" egli *caualcaua*, sopra questi drappi loro s'andasse", pranë *gomar* (II 23,22). Si e kemi shtjelluar te *ager*, fjalët *ager gare gaç* e *magar* paraqesin forma të ndryshme të një baze **gar* sot e zhdukur, e cila rron në ato variante. Nga ato, *gare* është femërorja më -e, *gaç* deminutivi më -ç. Format *ager* e *magar* janë kompozite me *a-* e me *ma-*; e para me theks përmbi prefiks, e dyta formim më i ri, me theks që ka qëndruar në pjesën e temës. Për *ma-* sh. Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4(1956) 81 v. Forma *margaç* e Bardhit do të ketë dalë nga **magar-ç*. Mbase prej *margaç* u shkëput *gaç* (sh. këtë fjalë). Në këto rrethana emri i *gomarit* në sllavishten e Ballkanit e në rumanishten buron prej shqipes. Edhe emri i *mushkë-s* ka shkuar prej shqipes te gjuhët fqinje.

mahajër f. "djerrinë". Kjo fjalë e ligjërimit të Kurbinit, sipas Joklit (Glotta XXI 121 vv.) rrjedh nga refleksi dalmatik i lat. **maiarium* "djerr", khs. it. *maggiatica*, *maggiatico*. Khs. dhe Walde-Hofmann II 13.

Me këtë duket të lidhet *majere-t* fpl. "terreni a scala o pensili" e Junggut e Bashkimit, te Cordignano "terreni disposti come a gradini". Është plurali i një **majár* ose *majér* nga **maiarium*. Për metafoninë khs. *gëlqere* nga *calcare*.

maj m. "çekan i madh i farkëtarëve; tokmak i drunjtë e i trashë i samarxhive"; *majth* m. "maj i vogël, çekiç"; *majëtuer* m. "ai që bie me maj". Pas G. Meyerit 255 më fort nga serbokr. *malj* "tokmak, majth" sesa drejt-përdrejt nga lat. *malleus* "çekan, rrahçë". Burimi latin shënohet me dyshim te Pedersenit KZ 33, 536, e pa rezervë te Puscariu EW 1017. Miklosichi (Alb. Forschungen II 475) e lë çështje të hapët punën e mundësisë së një burimi prej italishtes (*maglio*) o prej latinishtes. Nga it. *maglio* e nxjerr

fjalën Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss I² 1050. Andej duket se anon dhe Tagliavini 180, i cili ndërkaq e gjen të kotë mendimin e një ndërmjetësimi sllav.

Përdoret dhe për çekanët e dërstilës, Nopcsa 134. Në Malsi të Madhe pas Gazullit (f. 36, 247) ka dhe *maj ngë* f. "shtypëc drinit për me rrasë dhë me të", zgjerim me *-ungë* si *shëllungë*, Xhuvani-Çabej Prapashatesat 103. *maj* është një nga ato fjalë të shqipes, që përmenden në Revue de Linguistique VII 1 176 V, për të cilat çështja e burimit — a latin a italian — mbetet e pazgjidhur. Prania e fjalës latine në rumanishten (*maiu*) do t'ishte një dëshmi që *mallium* e ka pasur dhe latinishtja ballkanike. M'anë tjetër përhapja e ngushtë e *maj*-it përbrenda shqipes, e kufizuar në geg. veriore, flet më fort për një huazim relativisht të ri, prej italishtes. Një burim prej serbokroatishtes është më pak i besueshëm.

malcój "pezmatoj, mahis një plagë"; *më malcoi* "më mori pezmat plaga", *malcohet plaga*. Për G. Meyerin 256 refleksi i një lat. **malitiare*, prej *malitia* "ligësi, cilësi e keqe". Pranuar te Meyer-Lübke REW 5266a me formën e zgjeruar duke përfshirë dhe arom. *maritare* "me u keqësue" (për sëmundje), në pajtim me Capidanin (Dacoromania II 627 v.) që gjen këtu një fjalë të latinishtes ballkanike.

Del sëpari te Budi: *gjithë malcuom e jdhënuom* (për plagë); *e të lanë fjalëtë e këqia e të malcuoshime; plaga e lidhunë sã mã shpesh lëndonetë, aqë ende ma tepërë malcon; e lënduom e malcuom* (DC 130, SC 3, 162, 190); DG 194a (për hyjninë) *Se ish idhunë e malcuom Mbë qiellt atje ke r̄.* — Etimologjia latine nuk është bindëse. Nuk shkon as nga ana fonetike, se për *l*-në intervokale pritej për shqipen një *l* velare, e për *tj* një s, sh. dhe Revue de Linguistique VII 1 171. Fjalja spiegethet me mjetet e brendshme të shqipes. Në toskërishten *mëlcōhet plaga* "ëmbëlsohet plaga" është një eufemizëm për "malcohet, pezmatohet". Geg. *malcohet* mund të jetë identike me këtë, me ndrim *ë:a*, i shpeshtë në pozicion përpara theksit. Më anë tjetër shprehje si *m'a bā varra mal m'u* pezmatua plaga" (Tiranë, Shkodër) bëjnë të mundshëm një burim të verbit nga *mal*. Spiegimi i parë është më bindës.

mallotë f. "mantel i lehtë i malsorëve të Veriut". Mungon te G. Meyeri. Te Junggu e Bashkimi "mantello", te Nopcsa (f. 169, 196) "mantel i zi me lesh delesh, me kapuç e gjer në gju, nga poshtë i zgjeruar në trajtë koni". Më fort se drejtpërdrejt nga gr. *μῆλωτή* "gëzof", siç mendonim në Li. Posn. VII 181, a nga lat. e mesme *melota*, rrjedh nga refleksi turk i arab. *mall-ta*, kjo prej gr. *μῆλωτή* o *μῆλωτή*. Për fjalën arabe e për rum. *malotea* "mallotë grash" prej turqishtes sh. Lokotsch 1380, Dict. li. rom. moderne 474. Për arom. *malot* e gr. e re *malizt* Capidani (Dacoromania IV 258, 341) mendon një burim prej shqipes: sh. tani dhe Papahagi 653. Për përhapjen e fjalës greke në rusishten khs. Vasmer REW II 134.

man m. Që nga Potti (Blätter f. 2 këtej e afrojnë me dak. *μαντεία* "fryti i ferrmanzës" te Dioskoridi, te Pseudo-Apuleius *mantia*; khs. G. Meyer 257, Jokl (Litteris IV 200, Reallex. d. Vorgeschichte I 88), Weigand (Ethnographie von Makedonien 6, Balkan-Archiv II 213, III 236), Ostir Arhiv za arb. starinu II 289, Bertoldi Glotta XXI 258 vv., Sandfeld 95, Walde-Hofmann II 33, Rosetti Istoria limbii române II³ 60.

Fjalë e mbarë gjuhës, tosk. edhe *mën*, geg. (Shkodër, Elbasan) edhe *mand*; në Itali *mënezit* pl., në Atikë (Weigand, Balkan-Archiv II 213) *mënd*. Buzuku (IXL, Mateu 13,26) *kur u rit drithëtë e zu me zanë frujt, ashtu atëherë u dëftuonë edhe manemjdhëratë* "Cum autem crevisset herba et frucium

fecisset, tunc apparuerunt et zizania"; Bardhi Morus, moro albero *Man*. Nga *man*-i e kanë emrin vendet *Manëza* në Shqipëri, në Greqi *Μάνα Μίνεσι Μάνασι Μανάνι* etj., sh. Furikis 'Αθηνά 40, 26 vv., *Máni* emër familjeje në Piana dei Greci të Sigelisë e ndonjë tjetër. Ai djetar (poaty, dhe në Comptes-rendus du Vème Congr. Intern. des Etudes Byzantines) mendon që prej fjalës-shqipe vjen edhe emri i krahinës *Mani Mánia* në Moré, duke e çuar ai të dukurit e elementit shqiptar në Greqi gjer në shek. të XI. E kundërshton Schlumbergeri (Byzantion XIII) e P.N. Patriarcheas (Studi bizantini V 525 v.). Për historinë e fjalës (sh. dhe Bul. për Shk. Shoq. IV, 1953, f. 32) do shënuar se trajta e saj pa -d, *man*, si te autorët e vjetër të Veriut si m'anë tjetër dhe në toskërishten që grupin *nd* e ruan, duhet të jetë trajta e vjetër e gjuhës; geg. *mand* paraqet një -d sekundare, zhvillim thjesht fonetik i okluzivit si tingull homorganik pas *n*-së. Më anë tjetër një formë e lashtë (prehistorike ose e kohës antike) *man*-do të kish mbaruar sot në geg. **mā* tosk. **mē*, si *tan* në *atā atē* (Jokl IF 36, 98 v.), lat. *solanum* në *shullā shullē*, khs. dhe *mullā mēllē* nga një **mullān* etj. Ruajtja e *n*-së te *man* tregon se ka pasur një tjetër konsonant pas saj, që ndaloi shkri-rjen e saj me vokalin përpara në një vokal nazal. Ky konsonant pas gjithë rrethanave ka qenë një *d*, më parë një *t*, duke u vërtetuar dhe këtu zhvillimi fonetik *nd* : *nn* : *n* i gjuhës shqipe. Kështu pra vija e ndryshimeve të fjalës në shqipen ka qenë **mand* : *man*: (geg.) *mand*. Kjo e fundit ndërkaq është një formë regresive, jo një mbeturinë e gjendjes së vjetër, si mendon La Piana (Studi ling. albanesi. Varia 77). Në këtë mënyrë dëshmohet dhe nga rrethanat interne të shqipes afëria e fjalës me dak. *mantia*. Veçse kjo nuk do të marrë për një konkordancë parciale të shqipes me dakishten, për të vërtetuar një afëri të veçantë midis këtyre dy gjuhëve. Si e kemi treguar dhe në Studii si Cerc. lingvisticæ X 4 (1949) 559v., *man* bashkë me *mal* e me *karpë* është një nga ato fjalë që shqipja i ka të përbashkëta me trakishten e njëkohësisht me ilirishten: Si një mbeturinë të "ilirishtes alpine" e marrim në *mani* "framboise" që dëshmon R.A. Stampa, Contributo al lessico preromanzo dei dialetti lombardo-alpini e romanci (1937), sh. G. Gougenheim, Bulletin de la Société de Linguistique de Paris XXXVII.

mang m. "i vogli, zogu i një shtaze". Del si *ἀπαξ εἰρημένον* te Buzuku (LXXXVII=LXXXXVII, Kënga e këngëvet 2,9): *mbë këtë mēndyrë anshë i dashuni em, pors kaprolli o mangu i sutësë* "similis est dilectus meus capreae, hinnuloque cervorum". I përket rrënjës indoeur. **men-*, zgjeruar me -k **menk-*, duke u afruar me arm. *manr*" i vogël, i imtë" *manuk* "fëmijë, djalë", gr. hom. *μανός* "i hollë, i rrallë", lot *minor*, got. *minniza* "më i vogël", irl. e vj. *menb* "i vogël", e për punë të sufiksit *si-domos* me ind. e vj. *manāk* "pak, një çikë", tokar. B *menki* "më i pakë" het. *man-in-k* "me qenë i vogël", lit. *menkas* "i pakë". Shq. *mang* nga një **mank*, me sufiks deminutiv -ko. Fjalë e fondit indoeuropian të shqipes, e pavënëre gjer më sot. Në qoftë se është i drejtë emendimi i glosës *μάνυ πικρόν Ἀθαμάνας* në *μικρόν*, nga ana e Boisacqut (sh. edhe Markwart te Jokl IJ XIV VII 164), atëhere kemi një konkordancë të re midis epirotishtes së vjetër e shqipes.

mangulój "marr me të mirë, përkëdhel"; *manguláj* "ledhatar". E jep Gazulli për Malsi të Madhe. Nuk mund të ndahet nga rum. *magulesc* "ledhatoj", që e nxjerrin prej gr. se re *μαγουλεύω* "përkëdhel," nga *μάγουλον* "faqe", sh. G. Meyer Ngri. Studien III 41. Te fjala shqipe vihet re epen-teza e një -n-je, si te *manxhar* për *maxhar*, *andresë* për *adresë* etj. Rruga e depërtimit të fjalës greke në gjuhën shqipe ndërkaq mbetet e errët.

margjënuer m. "strehënën shkëmb". Fjalë e Shkrelit (Malsia e Madhe), te Gazulli, si sinonim i *gjamën-s*. Zgjerim me *-uer -ori* i një baze **margjën* nga lat. *marginē* "anë, buzë", një latinizëm i shqipes i pavënëre gjer sot. Mbi dëshminë e rum. *marginē*, të dalm. *mrgan* "kufi" (te Meyer-Lübke REW 5355) e të fjalës shqipe, *marginē* ka ekzistuar dhe në latinishten ballkanike. Fonetikisht do të pritej një **mërgjënuer* **mergjënuer*; *-a-në -ja* do të ketë dalë nga një *-ë-* në silabë paratheksore, si te *kanushë*, *kapucar*, *miqasi* etj.

marmur m. "mermer". G. Meyeri 260 shënon vetëm *marmar* e *mermér*, e para huazim nga greq, e re, e dyta nga turqishtja. Ai e lë mënjanë *marmur-in*. Më parë (Gröbers Grundriss I § 23, duhej §25) ai këtë fjalë e shënonte dhe e spiegonte me të drejtë nga lat. *marmor*. Pokështu dhe Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss I 1051. Përhapja e fjalës në mbarë gjuhësh flet në të mirë të burimit latin. Më një anë e kanë autorët e Veriut, më anë tjetër dialektet e Italisë. Budi (DC 149, RR 346,333) rreth njaj shtylli *marmuri cë ftohotë*; *ō të ftohotë mendje e zemëre, mā tepërë se marmuri ō akulli i ngritë*; *do zemëre marmuruom*; Bardhi Marmor *Marmurë*, *Marmoreus Marmor*. Në një këngë të vjetër prej Siqelie *Mbi një drasë të marmuri* "Su una lastra di marmo", Kamarda II 132. — Fjala latine ruhet dhe në rumanishten (*marmura*) e ka shkuar dhe në gjuhët sllave, khs. Puscaru EW 1033, Vasmer REW II 167 v, me literaturë. Prandaj, mbi dëshminë edhe të shqipes, mund të mendohet për ekzistencën e saj dhe në latinishten ballkanike. Gabim S. Riza (Fillimet e gjuhësisë shqiptare 20), i cili edhe *mermer-in*, huazim turk, e bie të ardhur prej latinishtes, sh. dhe Jeta e Re VI 46 (I. Popović) e 129 (S. Riza).

mastél m. "but i vogël, fuçi e vogël"; në Shkodër *mastelë* f. "gjysë vozge për me përvëlue petkat mbrendë (me i fijue)", te Gazulli 103. Del që te Buzuku: *As drita nukë ndhezetë me u cum ndenë një mastel* "neque accendunt lucernam et ponunt eam sub modio (LXXXVII=CVII, Mateu 5,15). Më fort se nga it. *mastello* (Mann 265) vjen nga ven. *mastelo mastela*. Fjala italiane ka hyrë dhe në greq. të re si *μαστέλλος, μαστέλλος*, G. Meyer Ngri. Studien IV 50. Një me *mastél* është fjala *marcél* "piccolo tino" e Arbëneshit të Dalmacisë, që ka mbetur pa spjegim te Tagliavini 183.

mashën f. "stan dhensh; shtëpi në vërri; kullë e sanës, kasolle e kash-tës". Mungon te G. Meyeri. E ka Bageri 46 (prej Rëkës së Dibrës) për "plevicë", Illyria (I Nr. 14 f. 8) për "kullë e sanës, plevicë" (për Dibër), Cordignano për "fienile", Mann për Elbasan e për Lumë me kuptimin "shtallë, shtallë gjedhash". Gjan të jetë singularizimi i pluralit me *-na mashna*. Singulari **mashë* pas gjase është lat. *massa* "brumë, grumbull, tok", me kuptimin e një godine baritore-fshatare, si del në it. *massa* "çiflik", *massaio* "ekonom", *masseria* "fermë e bujku", abruc. *massariye* "banesa e sipërmarrësit", vald. *maser* "zot shtëpie; stanar, përzitës" etj., sh. për këto Meyer-Lübke REW 5396.

mashterk m., *mashtër* f. "pjatë e drunjte e e thellë". G. Meyeri 262 e shënon prej Shqipërie, prej shqipes së Sllavonisë, e jep dhe për Greqi (pas Reinholdit Glosari 32) si *mashtërëq* "çanak", dhe e lë të paspieguar.

Fjalë kryesisht e gegërishtes, po që nuk i mungon krejt dhe toskërishtes, siç shihet ndër të tjera edhe nga prania e saj në dialekt të Greqisë. Del sëpari, si *mashtërëk*, te Buzuku (LXIV, Mateu 26,23): *Aj qi shtie dorënë ndë mashtërëkut tem, aj më trathëton* "Qui intingit mecum manum in parapside, hic me tradet". Nopca 100 dëshmon *mashterk* "vegsh, kuth" për Gojan të Mirditës, duke e marrë me Joklin si një fjalë vendi të shqipes. R. (Albania VI 1902, f. 143) jep formën *mashtër*: *Duket qi kë lpi shum kohë mashtër* (sahanat

t'Anadollakve. Të dyja format, *mashtë* e *mashtërk*, të Bashkimi, për "scodella di legno". Ed. e Re (Ser. VII, VII, viti i I, Nr. 3, f. 119) jep formën *maskë* "tas balte", Gazulli për Kelmend e Malsi të Madhe *maskë-u* "sahan" (shkruar jo drejt *mashk*), e për Mirditë f. 74 *mashtërk bukatuer* "qi zën miell për një bukë". Si një variante e *maskh-ut* paraqitet *maskur* m. "enë ku shprazet gjella për ta qitun në tryse", të Logoreci. Zgjerimi *mashterkore* f. (në Kthellë *krroqe*) është në Mat një masë drithi prej dy babunesh (Donisa, Cirka II 178). Si toponim *Mashterkorë* është një lokalitet i Mirditës afër Oroshit, në vitin 1671 *Mastrocori* (Armao 80, Gelasius—Gazulli HD XIV 137); është një emër topik marrë prej shtamaxhive, poashtu si *Kudhës, Vorpsi, Vorbajt* (sh. *kudh, vorbë*). Z. Harapi (HD IX 102 shën. 1,403) dëshmon *Kodra e Mashterkorve* pranë Oroshit si dhe *Mashtërkorë*, me shënimin se banorët e atij vendi punonin mashtërq dikur. Një toponim *Masktra* jep A. Sirdani (Leka XV 222) për Pland. — Vjen nga serbokr. *masur* "mashterk, çanak i drunjtë", e cila rrjedh prej gjerm. *Maser* gjerm. e lartë e vj. *masar* "gdhë, damar në dru; kupë prej druri me gdhë e me damarë"; sh. për fjalën serbokroate G. Sarmalović, *Nastavni Vjesnik* 20 (1920-1921) 411 vv., për fjalën gjermane Kluge-Goetze¹¹ 379. Ndrimi i s-së në sh dëshmon për një huazim mjaft të vjetër nga ana e shqipes. Serbokr. *masur* dha sëpari **mashtë*, e me zhvillim të një t-je në grupin *shr mashtë* *mashtë*. Me ngjitje të sufiksit -k u arrit në *mashtërk mashtërk*. Prej kësaj rrodhi *mashtk* (sot Malsia e Madhe), e me zhdukje të t-së në një grup tri konsonantesh *mask maskë*. Forma *mashtreq* e Reinholdit me q-në e saj mund të jetë një plural i singularizuar. — Për fjalët gjermane që kanë hyrë në shqipen nëpërmes të serbokroatishtes sh. Jokl, *Balkan-germ. u. German. im Albanischen* 123 vv. Khs. dhe *aliver, grendëll, kërtollë, kobel, krisje, krumpir, pehar, pushkë, sollar, stap, sule, shiklë, shinë, shojnicë, trumak, thoprk, vagir, vigan*.

mat "buzë lumi, breg deti". Fjalë e shqipes së Kalabrisë dhe e geg. veriore, mbetur pa spjegim të G. Meyeri 263. Vasmeri (*Studien* I 39 v.) sheh të -a-ja refleksin e një n-je sonantike, dhe e afron fjalën kështu me lat. *mons* "mal"; afrim i pranuar të Pedersenit *Reallex. d. Vorgeschichte* I 222 e të Bariçi *Lingvističke studije* 17, sh. dhe Marlekaj *Quaderni* V 47. Jokli (LKU 314 v.) shprehet kundër një afrimi të tillë dhe mendon për një burim prej gr. *μάδος* "kum". Ostiri (*Arhiv za arb. starinu* I 103, II 286, 288) e çonte *mat-in* të një bazë "alarodike" *mδ*.

Është një nga ato fjalë, që me përhapjen që kanë në geg. veriore më njërën e në arbërishten e Italisë më tjetrën anë, dëshmohet se janë të vjetra. Për përhapjen e saj në Kalabri khs. *çë sossën te matti ku është e stissur gora* "la quale termina nella spiaggia ov' è fabbricata la città", *te matti Asīs* "nelle sponde dell'Asia" te de Rada (*Fiam. Arbërit* II Nr. 1, 1885, f. III e IV). Për geg. veriore e dëshmon Cordignano. Ruhet edhe te emri i lumit *Mat*, i cili çfaqet që në kohën romake, të Vibius Sequester *Mathis fluvius*, sh. Krahe *Geogr. Namen* 28. Prej këtij lumi e ka emrin krahina *Mat Matja*, në thelb një femërore konsonantike si *gjind gjindja*, sh. Li *Posn.* VIII 115, *Revue de Linguistique* VII 1 172, 189 v., më parë Jokl *Slavia* XIII 616 v., 628. Mati te Anonymi *descriptio Europae Orientalis* e vitit 1308, botuar nga O. Górká (§ 70, sh. Jokl *IJ* VI VII 9) përmendet si njëri nga katër lumenjtë e Shqipërisë: "quatuor fluuiis magnis tota hec regio irrigatur, videlicet ersenta, mathia, Scumpino, Epasa", me trajtën *mathia* = *Matja*, e cila i përket *krahinës së Matit*; khs. prej Bardhit (f. 224) *Jam dheut së Matsë*. Për emërtimin e lumit prej brigjeve të tij khs. frgj. *rivière* "lumë" nga *rive* "breg". — Etimologjikisht *mat* afrohet me irl. *math* "rërë,

kum", Bul. për Shk. Shoq. III (1952) 57=Zeitschr. für Phonetik u. allg. Sprachwiss. IX 3 (1956) 227. Ky barazim përligjet me këtë, që për *mat* dëshmohet prej Veriu dhe një kuptim "kum zalli", e që më anë tjetër lumi i Matit rrjedh nëpër krahina ranore. Për një të tillë emërtim khs. emrat e lumenjve *Pesnica* në Serbi e *Piasnica* në Poloni, prej *pesak piasek* "rërë" (sh. për këto emra Fr. Ilešić IJ XIX XII B 230). Për *Matoas*, emrin e vjetër të Danubit, Budimiri (Comptes - rendus du III^e Congrès des Géographes et Ethnographes Slaves en Yougoslavie 1930, f. 353 vv. = IJ XVIII VII 166) mendon me rezervë një burim prej gjuhës së Skitëve. Poashtu tani rishmë dhe J.J. Russu, Cercetari de lingvistica V 1-2, 1960, 176. Kretschmeri (Glotta XXV 5 vv.) e afron me ind. e vj. *mādati mādāte* "valon, gufon, dëhet". Vasmeri (REW I 381) e krahason *Μίτοας* me *Matin* shqiptar, me çek. *Metuja* "degë e lumit Elbe", gr. (te Heziku) *μίτυς μέγας*, irl. e vj. *maith* "i mirë". Për ne *Μίτοας* afrohet me shq. *mat* e *Mat* e me irl. *math* "rërë". Pas gjase kemi të bëjmë me një konkordancë kelto-ilire e njëkohësisht kelto-shqiptare.

*mataró*j "mbaroj, rregulloj një punë (sidomos të shtëpisë), mbarështoj". Pas G. Meyerit 263 e Helbigut 96 nga it. *maturare* "me u pjekë" për "me krye", me një asimilim të silabës së dytë ndaj së parës. Pas B. Demës (HD XVII 418) nga lat. *moderari*. I drejtë mbetet vetëm mendimi i Joklit (Archivum Romanicum XXIV 37) që *mataroj* hyn në kategorinë e verbave intensive (a iterative) më -*ëroj*- (-ë)- *rroj* dhe që si një formim i tillë lidhet me verbin *mat*.

*mbarështó*j "rregulloj, administroj, krahishtoj". Del sëpari te Bashkimi si *marshtoj* "ordinare, amministrare, disporre, soddisfare", me emrin *marshtim* m. "ordinamento, amministrazione, disposizione, soddisfazione". Duke u nisur nga kjo formë, Jokli (Z.f. rom. Phil. 41, 233) e spiegon nga lat. *ministrare* "me shërbye". Në fjalorët e mëvonë fjala del e shkruar me *mb-*, si *mbarështoj mbarështroj*. Vjen prej *mbarë*, formim analogjik pas *mbrapshtoj*. Në Diber *mbarësoj* (nga *mbarë*) përdoret me kuptimin "mbarështoj". Forma me *m-* pajton me shqiptimin e Shkodrës, ku *mb* asimilohet në *m*, si ndër të tjera të *mbarë*.

mbars "bëj me barrë, *mbarsem* "mbetem me barrë"; *mbarsë* "me barrë". Etimologjikisht e afër me *barrë*, *mbarë* e *bark*, më tej me *bie*, *bir*, e jashta shqipes ndër të tjera me lat. *forda* "quae fert in ventre", gjerm. *gebären* "me pjellë", irl. e mesme *combrit* "mbarsë" etj.; khs. G. Meyer 28, Weigand 5, Walde-Pokorny II 155. Sikundër e shtjellon Jokli (te Walde-Hofmann I 457), me *mbars* *mbarsë* lidhet *mbratë* "mbarsë" (për dosa e për pela), te Bardhi Praegnans, grauida *Mbëratësë Mbërat*; dhe shkalla antike e *mbarsë*-s ruhet në glosën latine *equa bardia* "ἰππᾶς φορᾶς" (te Ernout-Meillet 103) që sipas Joklit përmban një ilir. *bardia* "mbarsë". Këtij barazimi ne si fjalë ilire i shtojmë dhe *βαρδῆν τό βιάζεσθαι γυναῖκίς Ἀμβρακίῳται* te Heziku, afruar prej Pisanit e Krahes, si refleks i një baze **bhordaiō*, me lat. *forda* "mbarsë"; kështu që *βαρδῆν* do të thotë në thelb "mbars"; ashtu si *bardia* "mbarsë"; shq. *mbarsë barsë* e *mbars* u përgjigjen pikë për pikë fjalëve *bardia* e *βαρδῆν*, duke përbërë të gjitha një grup leksik të vetëm; sh. Studii si Cerc. lingvisticæ X 4 (1959) 554. Te *mbarsë* e *mbars* përkundrejt *barrë* e *mbarë* kemi zgjerim me sufiks dental: *mbarsë* **bartiā* (G. Meyer), jo me sufiks gutural (-*k*) e jo me afëri të ngushtë me *bark*, si mendon Pedersen BB XX 238, Wiedemann poaty XXVII 231 e Sandfeldi 209. Këtë e vërteton *mberatësë* e Bardhit bashkë me të sotmen *mbrat* "mbars", si e shtjellon Jokli (te Walde-Hofmann I 457 e në leksione).

Raportin morfologjik midis verbit *mbars* e adjektivit *mbarsë* ky dijetar e shikon kështu që *mbars* është forma primare, dalë nga një **bhōratīō*. Nga puna se nuk ka në shqipen zgjerime verbale me -s-të thjeshtë e pa vokal përpara, ne nisemi nga *mbarsë barsë* si një postverbal i moqëm më -së (khs. *dosë*) dhe shohim tek ajo, me G. Meyerin, një **bartīā*. Verbi *mbars* është formim i mëvonë, një verb denominativ nga *mbarsë*. Edhe më e re është *mbarsohet* "mbarset" (I. H. Hyseni, Kop. letrar I 2). Për *mbëratësë* Jokli mendon një rregullim mekanik të akcentit, me shpërngulje në silabë të parafundit, pra nga sa duket **bhōrat: bārat* —: *bērāt*. Kjo formë ruhet dhe në tosk. jugore si *mbratë* "mbarsë" (për pela e për lopë), e përbën një nga konkordancat e këtij dialekti me geg. veriore. Morfolojkisht shohim një zgjerim të *mbar-* (*mbarë, barrë*) me -atë, me një zhvillim **baratē: *mbaratē: mbëratē: mbratē*.

mbath "vesh këpucët, çarapet, brekët, tozllukët; i vë potkua kalit; arnoj (shatin); i shtie pleh (arës), mbush me dhe rreth e rreth (patatet, misrin)"; *mbathem* "mbath këpucët, vesh brekët"; *mbathë* f. "të mbathurit e kalit; çdo gjë që mbath këmbën, si këpucët, çarapet etj."; *mbathje, të mbathura* fpl. "brekët"; *mbathtar* m. "nallban"; *zbath x bath xath dath* "xhvesh këpucët, çarapet, brekët"; *zbath kalin* "i heq potkonjtë"; *zbathem* "heq këpucët"; *zbathen bimët* "u dalin bimëve rrënjët mbi dhe"; *zbathur* "pa këpucë e pa çarape"; *zbatharëk* "që rri zbathur, këmbëzbathur". Afrimi që bën G. Meyer 264 me it. *basso* "i ulët, pjesë e poshtme" frgj. *bas* "çarape" span. *bajos* port. *baixos* "brekë; mbathje këpucësh", pra nga lat. *bassus*, me *th* për *s* e me *m-* e *x-* nga lat. *im-* e *dis-*, me të drejtë nuk ka gjetur pëlqim. Po edhe zbërthimi që bën Bariçi (I 54 v.) në *mb-ath zb-ath*, duke krahasuar -ath, si -adh, me lat. *exuo* "xhvesh" *induo* "vesh" lit. *aunū* "mbath", sllav. e vj. kishtare *obujo* "vesh" etj., për shumë arsye nuk mund të mbahet. sh. Tagliavini 186, La Piana Studi ling. albanesi. Varia 18 vv. I papranneshëm dhe mendimi i La Pianës, i cili merr për primare trajtat dialektore e sigurisht sekundare *dvath dath sdath*, gjen këtu një bazë *vdath* nga indoeur. **uodh-o-*: ags. *woed* "petk, litar", lit *audmi* "end" etj.

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Buzuku (XXXI, Gjoni 1,27; LVIII=LXVIII, Eksodi 12,11) *qi u atī nukë jam i denjë u me i zgidhunë rypetë e d bathunavet qī* "cuius ego non sum dignus ut solvam eius corrigiam calciamenti"; e të *mbathunatë* *tuoj mbathunë mbë kambët tuoj* "et calciamenta habebitis in pedibus"; Budi (DC 65,132, SC 88) *tue na mbathunë e tue na veshunë; dvathunë e dveshunë*; Bogdani (I 42,8) *ban këpucatë për të mbathunë* "nelle scarpe che fa per calzare". Tipi normal është *mbath*, e i opozitit është *zbath*, po ndeshen nëpër dialekte variante të ndryshme për të dyja format e verbit. Kështu primitivi *bath* te *m-bath* e te *z-bath* çfaqet si i tillë në disa ligjërime periferike: Vukli (Kelmend) *Me lesh ferrash i vesh e i mbath* (HD VIII 363 =Vis. e Kombit 4/II 274), *bathurë* edhe në ishullin Poros të Greqisë (Reinhold, Tekste 14), ndonjëherë dhe te Buzuku. Edhe opoziti *zbath* paraqitet me larmi dialektore: Bregu i detit me Çamëri e me kolonitë e Greqisë e t'italisë *xath xathur* (Reinhold 31, Kamarda I 90), me ndrimin *xv : x*, po në Contessa Entellina *zbarth* "zbathur"; geg. te Budi *dvathunë*, Puljevski *vdathun*, Fishta (Lidhja e Prizrendit) *sdathë e sdeshë edhe pa ngranë*, Sik (Çirka III 257) *desh e dathë*, Kurti (I² 99) *dathë e deshë*. Format *vdath dath* rrjedhin prej *dbath*, Budi *dvathunë*, me anë metazeze, sh. Jokl IF 37, 93; khs. dhe *borë dëborë dborë vdorë*, e *dëboj ddonj vdonj*, te Bogdani (II 70,2) *kjenë dvuem* "furon scacciati", *bjerr vjerr* etj. Për kuptimin do shënuar se të *mbathunat* ka ruajtur në gegërishten domethënien e këpucëve. Kështu pas Buzukut në shqipen e dikurshme të Istriës: *veni unasen ma gist, e tamba-*

sonat ma kamb (Bartoli, Studi albanesi I 8 v., Mjedja Leka IV 362), në mir-ditorçen e oborrit të Ali Pashës në Janinë e *ma veshëni e veni unazen më dor të ti, e ma mathni* (Luka 15, 22, te Pouqueville, Voyage dans la Grèce III 305), te Zanonë (Mateu 3, 11) *t'cillit s'jam i dëjë me ja majtun t'mathunat*. Në toskërishten të mbathurat ka marrë përgjithësisht kuptimin e brekëve, si në Gjirokastër, në Çamëri etj., prandaj pjesët biblike përkatëse për lat. *calceamentum* gr. ὑπόδημα përdorin këpucë: Grigori që atij nukë jam unë i zoti të unjem e t'i sgjidh ripn'e këpucëve të tij, Fiala e t'in Zoti (I Nr. 46 f. 1) atij u nukë jam i mirë t'i sglith, prëmist, rripet e këpucavet e tij. Po te Grigori gjindet dhe kuptimi i këpucëve: e virri unazë mbë dorrë të tij, e të mbathura ndë këmbë të tij (Lukas 15, 22). — Përdorimi i të njëjtës fjalë për të mbathurit e këmbëve e të mbathurit e kuajve ndeshet dhe në të tjera gjuhë: angl. *to shoe* "mbath, mbathem" e "mbath një kalë". Kuptimi metaforik i *ja mbathi* "ja hodhi" del edhe në arom. *ncaltsu*, megl. *ferec* "mbath" e "shpif për një, bigonis", sh. tani dhe Papahagi 735.

Për etimologjinë e fjalës është për të vënë re se shpeshherë në verbe ruhen dy format kompozite me kuptime të kundërta, pa u ruajtur primitivi me kuptimin origjinal të fjalës. Kjo ngjan sidomos me verbet që shprehin të veshurit e të mbathurit; khs. rum. *imbrac* "mbath brekët, vishem" e *dezbrac* "zbath brekët, xhvishem", po pa ekzistuar **brac*; lat. *exuo* "xhvesh" e *induo* "vesh" pa primitivin **evo-* **ovo-*; sllav. *izuti* "me zdathë" *obuti* "me mbathë" pa **uti*; khs. edhe rum. *inshid* "mbyll" pranë *deschid* "hap" pa **chid* nga lat. *claudio*; rum. *incure* "pështjelloj, ngatërroj" sajuar nga *descure* "shtjelloj, sqaroj" pas *inshid* — *deschid*, *imbrac* — *dezbrac*, Puscariu EW 514; lat. *queo* "mund, jam në gjendje" nga *neque it* "nuk ecën": *nequeo*, Brugmann te Ernout-Miellet 838, Walde-Hofmann II 402. Kështu edhe *zbath* ka dalë nga një **bath* "zbath" me anë të një përforeimi me *z*, si *zbraz* pranë *mbraz* prej serbokr. *prazan* bullg. *prazen*. Nga *zbath*, ku prefiksi *z-* u ndie gabimisht si një formant mohimi, u formua opoziti *mbath*. Edhe në të tjera gjuhë ka të tilla formime retrograde; khs. Niedermann Studi baltici III 108, vv. Fraenkel Rev. Et. Indo-eur. IV 21 vv. Kështu *zbath* përmban kuptimin primar të fjalës. Primitivi *-bath* të *zbath* mbath hyn në grupin lit. *basas* let. *bass* sllav. *bos*, arm. *bok*, të gjitha me kuptimin "zbathur", gjerm. *bar* "xhveshur" *barfuss* "zbathur" etj. Khs. për këtë grup fjalësh Berneker I 77, Walde-Pokorny II 189, Pokorny I 163 (me literaturë), Vasmer REW I 111, Fraenkel 36. Si bazë indoeuropiane pranohet përgjithësisht një **bhoso-s* "lakuriq". Fjala e shqipes me *th-në* e saj paravendon një bazë me *k* palatale, ose me *-sdh* *-zdh*, e kështu i shton vështirësitë e spjegimit formal të rrënjës indoeuropiane. Ndërsa fjalët balto-sllave me *s-në* e tyre mund të reflektojnë një *k* palatale, gjerm. *bar* me faresin e saj te *r-ja* duhet të pasqyrojë një *s* të lashtë. Për kuptimin do shënuar se verbi i shqipes mbështet mendimin e Pedersenit që domethënia e rrënjës indoeuropiane ka qenë "zbathur", mendim që e vë në dyshim Walde-Pokorny. Nga pikëpamja e historisë së shqipes *mbath* hyn në konkordancat pjesore të shqipes me armenishten, sllavishten e baltishten, për të cilat flet Pedersen në Reallex. d. Vorgeschichte I 223. — Sh. dhe mbërthej.

mbërthëj "kopsit; ngallmoj me gozhda, gozhdoj; zë, kap"; *mbërthhem* "kopsitem; kapem, përleshem me një"; *mbërthekë* f. "kopsë"; *zbërthëj* "çkopsit; shkulo gozhdat nga një dërrasë e mbërthyer", figurshëm "zgjidh" (një çështje); *zbërthim* m. G. Meyeri 265 mendon — me dyshim — lat. *invertere* e *disvertere* si baza për *mbërthej* e *zbërthej*, ashtu si *kthej* sipas tij nga *convertere*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Me të afrohet jo *mbërshelinj udhënë* "intercludere

iter" e Bardhit si mendon G. Meyeri (ajo është *mbërshel* "mbyll" që shkon me *çel*), po *shpërthej*, *çpërthej*, një variante prefiksale e *zërthej*, te Buzuku (LXXX=LXXXX, Apokalipsi 5,9) *I denjë je, . . . me përzanë letërënë e me çpërthyem të mbërthyemetë e saj* "Dignus es accipere librum, et aperire signacula eius". Budi (DC 150, 184b, 203a) *me goshdët . . . i mbërthyenë kambëtë e duortë; Idhunë me të çbërthyem; Posi luleja çbërthij Faqa jote ngushëlluom*. — Në çamërishten e në shqipen e Greqisë *mbërthehem* përdoret dhe për bashkimin seksual të kafshëve femra: Reinholdi (Glosari 41 v.) *mbërthej* "infibulare; de coitu: *pela, lopa, dhia u mbërthie, ishte mbërthierë; zërthej* "déboutonner", sh. dhe G. Meyer Alb. Studien V 95; çam. (te Pedersen 39) *edhe u -lëshua pela mbi kal, edhé kali mbi pel, edhe u-mbërthien*. — Për etimologjinë do vënë re se *mbërthej* në punë të farkimit me gozhdë është sinonimi i *mbath*: *mbërthej gozhdën — mbath kalin*; khs. dhe *farkoj* që ka të dyja kuptimet, "mbërthej, gozhdtoj" e "mbath kalin". Prandaj *mbërthej* është një zgjerim me -ej i *mbath*; *mbërthej* me reduktim të a-së së pathekse në ë (gaz gëzoj) e me zhvillim të një r-je inorganike midis ë-së e th-së. Për -ej khs. *nzej*: *ndez*.

mbërrij, *mbrij*, *mërrij* "arrij". G. Meyeri 17 sheh këtu një formë të *arrij* përngjitur me *mbë-*, duke spieguar *arrij* nga it. *arrivare*. Weigandi 57 e nxjerr fjalën nga lat. *adripare*, përngjitur me *mbë-*.

Del që te Buzuku (LI, Mbretërit IV 5,6; LIII, Gjoni 4,27): *Kur këjo letërë të mbërrinjë ndër duor të tû* "Cum acceperis epistolam hanc"; *E ndërkaqë mbërritinë dishepujtë e tu* "Et continuo venerunt discipuli eius". Budi (DC 196 b, RR 351) *E mbramanet ia mbërrini; po t'ini të çpejtë e të mbërrishim*. Bardhi *Pervenire Me mbërrim heret*; Bogdani (Përgjegjji zoti Jank) *e ndër kohët mbërrina mbë vend qi kishim thanë* "e a tempo giunsi al loco destinato". Si transitiv te Kristoforidhi (Gjaja e Malsorit, Kopështi letrar 5,11) *këndoni ende shpejtoni këmbëtë, se e mbërrim ende për pak herë zamë rrëzën e malit*. Morfologjikisht *mbërrij mbërrij mërrij* është një verb i zgjeruar me -inj -ij, si *mbëllij*: *mbyll*, *kërpinj*: *kryp*, sh. të tjera shembëlla te *hyj hij*. Kjo analizë shpie te *mbar-7nj*, një denominativ i *mbarë*, edhe kjo e fundit në thelb një postverbal i *mbar*. Në krahasim me *mbaroj* që ruan -a-në e pathekse, *mbërrij* me -ë-në e saj është një formim verbal mjaft i vjetër. Raporti fonetik është ashtu si te *bëruo*: *bari*. Te *mbërrij* ka një geminacion ekspresiv të r-së. Për zhvillimin kuptimor të *mbërrij* nga *mbar* khs. i *mbërrishim* te Budi që pas gjase është sinonimi i të shpejtit, e për këtë khs. lat. *celer* "shpejtë" që etimologjikisht afrohet me shq. *qell*.

mbiatu "n'atë ças". Fjalë e shqipes së Kalabrisë. Pas Kamardës (II 453) kompozit gjysmë shqip e gjysmë italisht, shq. *mbi* e it. *atto* = *sullato*, *nell'atto*. Këtë mendim ndjek edhe G. Meyeri 265 e Helbigu 111.

Është një nga ato fjalë që kanë dalë nga leksikalizimi, nga shkrija mënjë e një gjymtyre të fjalisë, nga *mbi atë* me kuptimin "mbi ato (fjalë), në ato fjalë, në ato e sipër, n'atë ças". Këtë e vërteton *mbiattë* që ekziston krahas me *mbiatu*. Kjo e dyta p.sh. te Kamarda (II 114, 153): *E mbiatu u ndajtin* "E tosto si separarono", *Zonjës mbiatu i vān s'itë* "Alla signora subito vi andarono gli occhi", e te V. Stratigoi (Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 1, 1959, 84): *Ë i sëmurë? mbjatu m'e shëron*; ajo e para te de Rada (Raps. alb. 85, Skand. i pāfān V, 1877, libri IV, hist. IV III 42): *E mbiattë leyët ka dera u pruarin*. Përdoret dhe në Shqipëri, po zakonisht si dy fjalë të ndara *mbi atë*; kështu te Pedersen 83 *Mbi atë vanë xhinëritë, u mbliudhë e e vunë në mes*. Khs. edhe *E përmbi gjithë këto Moiseu u dha të përenëtë* "Propterea Moses dedit vobis circumcisionem" te Buzuku LVII/2, Gjoni 7,22; te Kristoforidhi (Psalmet geg. 104,20; Gjoni 4,27)

Lishon errësinë, e bâhetë natë: nd'atë shkjojënë gjithë bishat'e pyllit; Edhe mbi këto fjalë erthnë dishepujtë e t'i. Kështu kjo fjalë për nga forma i përgjigjet gr. *ἐν τούτῳ* "ndërkaq", frgj. *sur cela, là-dessus* "mbi atë, mbi ato fjalë", angl. *thereupon*, khs. dhe gjerm. *indes*. Vokali fundor -u -në qoftë se s'është thjesht grafik për të dhënë ë-në ose një variacion fonetik të kësaj — mund të ketë dalë nga errësimi i saj në fund fjale, si te *nuku* për *nukë*. Grafia *mbiattu* me *t* geminate o është fonetike ose thjesht grafike. Në çdo rasë përemri atë del me -ë të pathekse, ashtu si në çamërishten (*atë*) e në geg. veriore (*at*). Forma *mbjatu* e V. Stratigòit gjan të jetë më afër shqiptimit popullor se *mbiatu*.

mblatë f. "oste, bukë meshe, meshë"; *blatëtuar, mblatës, mblatuer, latëtuar, latuer* "formë e drunjtë me të cilën vulosin bukët e meshës"; *blatój mblatój* "i falmbllata hyjnisë". Nga lat. *oblata*, G. Meyer 38, Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1054. Khs. dhe Jokl LKU 292.

Forma *mblatuer blatëtuar latëtuar latuer* nuk vjen nga një lat. **oblatorium* ose **oblatorium* e supozuar, e cila nuk paraqitet asgjekund në gjuhët romane, po është një zgjerim i brendshëm i shqipes, sh. *Revue de Linguistique* VII 1 194. Pas mendimit tonë nga lat. *oblata* rrjedh edhe fjala *ablëdda* "bukë elbi e vogël" në greqishten Otrantos në Apuli, të cilën Rohlfis EW 2677 e numëron ndër fjalët me burim të paditur.

mbloj "mbush", te Leake (Researches in Greece 306) *plonj*, te de Rada (Poesie alb. VI 18) *pumbjohej* "rritej". Pas G. Meyerit 265 nga lat. *imptere* "me mbushë". Pranuar te Puscariu EW 1807.

Fjalë e përbashkët e tosk. jugore dhe e shqipes së Greqisë e t'Italisë: tosk. jugore *fs hije odën, se është mbluar plot me pluhur*; në Gjirokastër në këngë dasdash e këndohet nuses *shtëpinë plot djem e mblofsh-e*. Në Siqeli *mbloj mblonj* (*Me t'ëmbël e me gaz jetën më mblove* "Di dolcezza e di gaudio mi riempisti la vita", Schiró Ca. trad. 70), në Kalabri *mbjonj*. Në Markopullo t'Atikës t*ë Shtëpunë mbrëma ç'erdhe M'e bljove gjinë ljet* "τό Σάββατο βράδυ πού ήρθες, Μοῦ γιόμισες τόν κόρφο δάκρυα (Laographia I 89, edhe f. 101, II 110); poashtu në Spata të Atikës, sh. Furikis, *Αθηνά* 45.96. Fjala pas gjithë gjasëve ka pasur një përhapje më të përgjithshme në gjuhë, po u tërhoq përpara *mbuloj*, me të cilën piqet dhe në kuptim. — Spiegimi latin nuk qëndron, lat. *e* e gjatë ka dhënë në shqipen po *e* e me diftongim *ie*, khs. *vëlej, mishërier*, e sh. për këtë edhe Jokl, *Archivum Romanicum* XXIV 20. Me më të drejtë Kamarda (I 125) e afron fjalën me *plot* e me gr. *ἐμπλεως* "plot". Me gjith'atë nuk do menduar një bazë e lashtë **plen-*. Spiegimi i saktë gjindet te Lamberti (Li. Posn. VII 71): *mbloj* nga *m+plot*, me sonorizim të okluzivit si te *mblakem, ngugem*. Pra *mbloj* një denominativ nga **mplotnj* si *muj* nga *mundnj*. Pa prefiks forma *plonj* e Leakut. — Sh. dhe *mbuloj*.

mbufás "fryj, ënjt", *mbufatem mufatem* "fryhem, ënjtem"; *u mbufat gropa me ujë* "u mbush sa s'nxë më". G. Meyerit 54 *mufas mufatem* bashkë me *burfuat* (sh. këtë fjalë) e nxjerr nga it. *buffare* "me fry me bulçi plot". Ravën e tij ndjek edhe Shp. Bardhi HD XI 311. Weigandi 58 e bashkon me një *buf*, të cilën nuk e spiegon më tej. Rrjedh prej sllav. (bullg.) *puhati* "me fry", formë perfektive, sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, *Seria Shk. Shoq.* 1 (1958) 63 shën. 242 Përkundrazi imperfektivi *puhaviti* ruhet te *buhavis buhavitem* (sh. këtë fjalë). Te *mbufas* kemi shtesën e një prefiksi *m-*, i cili te *mufas mufatem* ka asimiluar okluzivin. Trajta e thjeshtë ruhet te *bufas bufatem* që jep Mani. Te *buhatem* "dilatarsi, slargarsi" e Bashkimit kemi trajtën veriake të kësaj. Te kjo ruhet -h-ja, e cila te *mbufatem, mufatem* e geg. jugore u labializua. Sh. edhe *buf, buhua, burfuat*.

mbul'm m. "burim, gurrë". Këtë fjalë, e cila mungon te G. Meyeri; Jokli (LKU 271 v.) e gjen te S. Peci (Lirija 108., I, 4) dhe e afron me *Bulentum*, *Bulenta de Ombla*, *Buleto*, emrat e burimit të Omblas-s afër Raguzës në Dalmaci; te *mbulim* ky dijetar sheh një fjalë të afër me *amull* (sh. këtë), e te *Bulentum* ai gjen pas gjase (IJ VIII VII 84) një emër ilir. Aty shprehet dhe kundra Skokut, i cili te *Bulentum*, *acqua di Bollento* shihet refleksin e lat. *bullire* "me value" që rron dhe në engad. *buol* "krua, burim, vorbull uji".

Në dialekt të Korçës (S. Peci ishte prej Dardhe) fjalët me *b-* paraqesin shtesën e një *m-*je: *mbletë* "bletë", *Mborje* prej bullg. *bor* "pishë". Kështu *mbulim* është *bulim*, një postverbal i *bulon*. Kjo përndryshe, si donominativi i *bulë-s*, do të thotë "çel lule, end, mugullon", po pas kuptimit "pikë uji" që ka *bula* (*asnji bulë uji*) përdoret edhe për "qes bula uji, ziej, valoj", khs. *ay buloi e mori valë* te Manni. Prandaj *mbulim* rrjedh gjithsesi prej *bulë-s*. Me këtë ndërkaq nuk përjashtohet një afëri me emrin e burimit *Bulentum*, sidomos kur ekziston *buloj* "ziej, valoj". Edhe tjetri emër i atij burimi dalmatin, *Ombla*, rrjedh prej shqipes, nga *ambël*. Në goftë se te *bulë* kemi një huazim nga lat. *bullā* (sh. *bulë*), *Bulentum* mund të jetë i një burimi roman ose iliro-roman. Në goftë se *Bulentum* është një emër i vjetër ilir, lëkundet puna e burimit latin të *bulë-s*.

mbulój I, *zbulój*; *mbulim* m. "kapak, mbyllës; varrim"; *mbulesë* f. "çdo send që shërben për të mbuluar; batanie; kapak, mbyllës"; *mbulesa e shtëpisë* "çatia", *shtresë e mbulesë* "dyshek e jorgan"; *mbulicë* f. "peçe e fytyrës"; *mbulojë*, *mbulomë* f. (me gr. — $\omega\mu\alpha$) "mbulesë". Me këtë fjalë G. Meyeri (f. 267) bashkon brenda shqipes *mbloj bloj fjoj vlyej* "fejoj", *vlesë* f. "fejesë" *mbles* (shkruar *mbleës*) m. "shkues, lajmës", *mblesëroj* "bëj një krushqi"; *mbuloj* e *mbloj* e nxjerr nga një lat. **invelare*, prej *velum*, e *zbuloj* nga **disvelare*. Etimologji e pranuar gjithkund: Pedersen KZ 33, 538 (me disa rezervë), Weigand 56, Puscariu Dacoromania I 424 (Skok), Philippide II 65 e 670, Tagliavini 187 (me literaturë), La Piana Studi ling. albanesi. Varia 19.

Një huazim latin i sigurtë, *ftoj* nga *invitare*, dëfton si reflektohet lat. *inv-* në shqipen në ballë të fjalës. Prandaj **invitiare: mësoj* është dyshimtë. Krijt e pamundur është **invelare: mbuloj* e **disvelare: zbuloj*: jo vetëm për punë të grupit nistor *inv-*, po edhe sepse *l-*ja intervokalike latine pas rregullës së ditur të Pedersenit (KZ 33, 535 v.) do të kish dhënë në shqipen një *l* velare. Këtyre arsyeve fonetike u shtohet dhe kjo, që *invelare* ndeshet vetëm si *invelatus* në latinishten e vonë, edhe aty rrallëherë (sh. Ernout-Meillet 1082), dhe që nuk rron askund në fushën e gjuhëve romane (rum. *invali* "me veshë" rrjedh prej sllavishtes). As **disvelare* nuk dëshmohet gjëkund në latinishten o në botën romane; është rindërtuar nga Puscariu (Dacoromania I 424) vetëm në bazë të rum. *se dezbara* "me u xhveshë" e të shqipes *zbuloj* e pranuar te Meyer-Lübke REW 2697. Brenda shqipes *zbuloj* nuk ka si ndahet nga *mbuloj*. Ajo nuk është veçse një zhvillim i brendshëm formuar pas *mbuloj* si opoziti i saj, ashtu si *zbledh* pas *mbledh*, *zbrej* pas *mbrej* etj. Për *mbuloj* vetë ka rëndësi rrethana që kjo në burimet e vjetra të shkrimit e nëpër dialektet periferike paraqitet më shpesh si *mbëloj* ose *mbloj*. Kjo na bën të mendojmë që trajta e sotme është sekundare, me një u zhvilluar prej *ë-së* në silabë paratheksore; khs. për një zhvillim të tillë *mbroj* e *mproj* e *mburoj*, te Buzuku *përonj*, nga lat. *parare*. Gjejmë kështu te Buzuku (XXXVII, Isaia 60,2) *Hinje se t' erëtitë mbëlon dhenë, e niegulla popujtë* "Quia ecce tenebrae operient terram, et caligo populus". Budi me Bardhin kanë trajtën më *-u-*: Budi (DC 6, 146, 197a)

qi janë mbuluom; kafshë të buluome e të mshehuna; Shekulli gjithë mbuluom...
As maje mali xbuluom; Bardhi Contegere, Operculare, Operire, Tegere
Me mbuluem, Operculum Të mbuluem, Plumosus (gabim shtypi për Plum-
bosus) Mbuluem ndë plumb. Po Bogdani (I 70, 3, II 102, 11; 55, 17) Ngadhë
njyesit kam me dhanë Mannënë mblueme "Vincetit dabo manna abscondi-
tum"; I mbëluenë faqenë me një të qelbëtë, e të shqerrë pëllhurë" Gli copere-
sero la faccia d'un sucido, e ricapezato pannicello"; hipnë mbi lëposat
tue zbëluem të shtruemitë "montarono sopra li tetti, e scoprendo il pavi-
mento". Trajta mbloj, e cila del që te Bardhi (Reponere Me e mbluem),
 gjindet edhe sot, brenda e jashtë Shqipërisë: Gorvoka e Koqës (Jeta e Re, maj-qershor 1955, f. 194) me t blua, Kosova mbloj "mbuloj" shpjoj "zbuloj", Dibra mbëloj e zbëloj. Në një këngë popullore të Veriut *Fill zotnia na ásht shplue* ("zbulue"), në Shoshan të Kolgecajt (Tropojë) *Cien e djathtia leni çplue; shpjoj shpjue (pl : pj)* në Nikaj-Mertur (E. Lafa); *mbloj* dhe në Borgo Erizzo (Tagliavini), pas Weigandit *mloj*. Kjo trajtë rron dhe në toskërishten, në Skrapar *mblonj* "ngërë diçka që mos humbasë ose të prishet", e cila piqet me *me e mbluem* "reponere" të Bardhit. Në të mirë të mendimit që trajta e vjetër e fjalës ka qenë *mbloj*, flet përveç këtyre edhe *mbloj bloj* "fejoj", e cila, si e pa G. Meyeri, ka dalë nga ideja e të mbuluarit: në përdorimin e vegantë u ruajt trajta originale, e cila në të përgjithshmin u zhduk. Në këto rrethana *mbuloj* shihet se nuk është gjë tjetër veçse një variante e *mbloj* "mbush". Kuptimet "mbush" e "mbuloj" piqen nganjëherë. Nga fusha e shqipës khs. për këtë gjë tosk. jugore *fshije odën, se është mbluar plot me pluhur*, ku *mbluar* mund të jetë "mbushur" ose dhe "mbuluar", çam. *sitë plot lot ç'i mbulova* te Pedersen 100, të cilën ky dijetar f. 157 e spiegon disi ndryshe; khs. dhe *Gjithë shekulli u mbluot* te Budi DC 199. Për fazën *mbëloj*, e ndërmjeme midis *mbloj* edhe së sotmes *mbuloj*, khs. *gëluri* "gluri" e *pëlori* "plori" në arbërishte të Siqelisë. Për ndrimin *ë : u* në silabë paratheksore khs. *mëzat : muzat, skëtërrë : skutër*. Me këtë rrugë u arrit në dy fjalë të ndryshme, si nga forma si nga kuptimi. Kjo mbase është edhe arsyeja që në pjesën më të madhe të shqipës *mbloj* nuk ruhet më, sepse e la mënjanë e reja *mbuloj*. — Idenë e një afërie midis *mbuloj* e *mbloj* "mbush" e pat dhe Kamarda (I 61), po e largoi pastaj (I 125).

mbulój II. "vulos". Gjindet vetëm te Buzuku, dhe atje si *ἄπαξ εἰ-
 ρήμενον : E ata vonëte e vonë s(h)trazëtë vorit (tue) mbuluom gurrë, me
 s(h)trazët qi e ruonjinë* "Illi antem abeunte, munierunt sepulchrum, signan-
 tes lapidem, cum custodibus" (LV/2=LXV/2b, Mateu 27,66). Sigurisht
 fjalë latino-romane, po mbetet e dyshimtë a nga lat. *bullo* apo nga it. *bolla*.
 Për burimin italian është Helbigu (f. 84,112), duke nxjerrë *bulën-n* e Kristo-
 foridhit nga *bolla* e *bulatis* "vulos" të Junggut nga *bollare*. Forma e Kristo-
 foridhit, që gjindet vetëm nëpër tekstet e tij, jo në Fjalor (e ka dhe G. Meyeri
 479), mbetet fort e dyshimtë, është më fort një fjalë librash, normalizim
 i *oulë-s*. Përkundrazi *bulatis* e Junggut gjan të jetë popullore e tëshkojë
 me *mbuluom*-in e Buzukut. Në qoftë se është latine, rrjedh prej lat. mesje-
 tare, ashtu si gjerm. *Bulle* (sh. Kluge-Goetze 86) e gr. e re *βούλλα* (G.
 Meyer, Ngri. Studien III 17). Në qoftë se është it. *bolla*, fjala ka pësuar
 atë ndrim *o : u* si *dupje* etj. që trajton Helbigu 39 v. Verbi *mbulonj* mbetet
 pezull nëse është denominativi i një *bule* të shqipës, apo refleksi i pandër-
 mjemë i lat. *bullare* o i it. *bollare*. Në çdo rasë është një fjalë e administratës
 mesjetare të Shqipërisë.

meksh m. "viç i buallicës, kotorr". Mungon te G. Meyeri; e ka Junggu
 si *meksh* "il nato della bufala" e Bashkimi si "vitello o nato della bufala".

Fjalë e mbarë gjuhës, meqë del dhe në Jugë si *mëksh* "viç" e si emër familjeje *Mëkshi Mekshi* në Labovë të Tepelenës, në fillim ofiq. *Mekshi* emër familjeje në Elbasan. — Gjan të jetë ngushtimi i një kuptimi të përgjithshëm "i njomë, i lagët" e të ketë kështu lidhje me *mekem*, *mek* "njom, rij" i *mektë* "i paterur mirë, i patharë mirë". Shkalla kuptimore pra do të ketë kaluar nga "i njomë" në "shtazë e njomë, zog shtaze" e andej në "viç, viç buallice". Sufiksi *-sh* o deminutiv si te *vogëlsh*, *lëmsh*, *brásh*, *Niksh*, ose sufiks ablativi shumësi si te *viç*=*vit-sh* me *vit*, te *dysh*, *vjamsh* *frymsh* etj. Sh. për këtë sufiks Xhuvani-Çabej, Prapashtesat 83 v. Për kuptimin khs. dhe i *lashtë*, *gengj*.

mendër f. "Mentha piperita, dhjozmë". Merret, që nga Miklosichi (Alb. Forschungen II 41) e këtej, për një huazim nga latinishtja (*menta*, *mint*); sh. Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1044, Weigand 53, Jokl LKU 232. I këtij mendimi kishte qenë më parë dhe G. Meyeri (Alb. Studien I 55); po ky më vonë (EW 272) e nxjerr nga it. *menta*. Poashtu dhe Helbig 124.

Zgjerimin me *-r* G. Meyeri e vë në një radhë me atë që shihet te *i shkurtën* i *shkurtër* nga lat. *curtus*, *i shurdhën* i *shurdhër* nga *surdus* etj. Mendim jo i drejtë, sepse atëherë do të kishim në gegërishten "mendën. Më fort një sufiks deminutiv *-ër -ërr* si te *çimërr*, *kandër(r)*, *puçër(r)*, për të cilin khs. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 42. Në këtë rasë *mendërz*, kal. *mëndrëzë* është cilësuar dyfish si deminutiv. — Për etimologjinë do thënë se për një fjalë që është e mbarë gjuhës mendimin e një burimi prej italishtes ta largon mendja a priori, burimi latin ka më të gjarë. Ndërkaq *mendër* si emri i një bime të kuzinës mund të ketë rrjedhur drejtpërdrejt nga gr. e vj. *μίνθη μίνθα* *μίνθος*, poashtu siç është marrë më vonë edhe *dhjozmë* prej greqishtes. Kështu ky emër bime do të hynte në ato fjalë të shqipes, për të cilat mbetet e pasigurtë a burojnë prej latinishtes apo pandërmjetësisht prej greqishtes; sh. për këto fjalë Revue de Linguistique VII 1 181v. Ka mënfund dhe një tjetër mundësi burimi, atë nga një gjuhë mesdhetare, nga e cila pranohet përgjithësisht se rrjedh dhe fjala greke me gjithë latinën. Për të tilla fjalë të shqipes sh. te vendi i cituar, f. 184, e Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4(1962) 125, 141.

mendull f. "bajame". Kjo fjalë, e cila del që te Bardhi: Anygdala *Mendulla*, rrjedh pas mendimit të përgjithshëm nga ven. *mandola*; sh. Miklosich Alb. Forschungen II 485, G. Meyer 258 v., Helbig 56, Tagliavini 189v. Forma *mendul* e arbërishtes së Italisë nga italishtja jugore: neap. *ammennola* etj., siç tregon G. Meyeri e Lambertzi KZ 53, 293. Për format itالية jugore khs. edhe Rohlf's EW 117.

Burimin nga ven. *mandola* G. Meyeri e përlligj duke transkribuar formën e Bardhit me *mëndullë*. Po fjala është *mendull*, si e ka dhe Bashkimi e të folët e Arbëneshit të Dalmacisë, e kjo s'ka si të ketë ardhur prej ven. *mandola*. Prandaj rrjedh prej lat. *améndala* (ose lat. vulgare) *améndola*, që rron në një radhë gjuhësh; sh. për këto Meyer-Lübke REW 436,2 për *amendola* W. Schulze KZ 33, 375 (te Vasmer REW II 135). Nga pikëpamja e shqipes nuk ndahet dot se cila nga dy bazat latine është burimi i *mendullës*: sepse *y*-ja latine (e greke e vjetër) është trajtuar në shqipen si *i*, e pra ka dhënë edhe ajo e në këtë gjuhë, khs. *chersydrus* : *kulshedër kuçedër*. Ndërkaq nuk përjashtohet një burim drejtpërdrejt nga greq. e vjetër, nga *ἀμύνδαλα* që dëshmon Rohlf'si EW 117 me anë të Corp. gloss. III 316.14.

merá f. "kullotë, qoftë e fshatit qoftë private" Junngu "pascolo di uso pubblico". Nga turq. (arab.) *mer'a* "kullotë", sh. edhe Mann 277. Fjala turke ka shkuar dhe në bullgarishten (Mladenov 294), e si *miriste* dhe

në rumanishten, sh, Lokotsch 1403. — Nga plurali *meraja meraje* ka dalë si një formë e singularizuar, *merajë* "kullotë dimëri, vërrë", të cilën G. Meyeri (f. 259v. te *maraj* e f. 471) e spiegon nga një lat. e rindërtuar **hibernālis* **hibernāle*, e Jokli (IKU 265), nga një lat. **invernālia*. Sh. për këtë fjalë Li. Posn. VIII 80v. Në të mirë të spjegimit tonë flet dhe rrethana që Hahni (f. 74) *merajë* "vërrë" e shënon shprehimisht si fjalë të gegërishtes dhe që bash ky dialekt përdor një -ja si eksponent të pluralit si të të mëdhaja. Ndërkaq fjala pas gjithë gjasëve njihet vetëm si plural *meraja meraje*, singularin *merajë* do ta ketë ndërtuar Hahni. Dhe E. Vlora (Aus Berat und vom Tomor 66) *meraje* e ka vetëm si plural, me kuptimin "kullota". Kështu pra vetë ekzistenca e një sing. *merajë* mbetet fort e dyshimtë.

merimagë, *merimagë* f. "Aranea." G. Meyeri 274 e jep me format *mërimagë mërimangë marimagë bairimagë*, te Dozoni *mjerimagë*, në shqipen e Greqisë *milimagë*, edhe aromunisht *merimagë*. Pjesa e dytë e fjalës sipas tij mund të jetë sllav. e vj. kishtarë *paakъ* "merimagë", dhe e para cungimi i ndonjë emri tjetër të *merimagës*, si *kamarjë*, ose i ndonjë fjale që të ishte e afër me lit. *vóras* "merimagë". Më parë (Alb. Studien I 77) Meyeri mendonte, me rezervë, si burim gr. e re *μερμήγγυ* "thnëglë, mizë përdheskë".

As njëra etimologji as tjetra nuk mund të qëndrojë, kryesisht për arsye fonetike; gr. e re *μερμήγγυ* ka dhënë në shqipen *merming*, sh. Meyer 270. Si e ka vënë re mirë ky dijetar vetë me një tjetër vend (f. 171) me rastin e fjalës *kamare kamarjë* "merimagë", *merimaga* shpeshherë e ka marrë emrin prej shtazësh së tjera që i përgjasin. Prandaj te *merimagë* ruhet emri i thnëglës në greq. të vjetër *μέρμηγξ*. Veçse kjo nuk arrin të spiegojë formën e fjalës shqipe. Baza e kësaj është *μέρμαξ μέρμακος* e dorishtes — dhe sigurisht edhe e greq. veriperëndimore — e cila iu shtrua rregullimit mekanik të akcentit në shqipen. Te *merimagë mërimangë* etj. u ka zhvilluar një -n- epentetike, e shpeshtë në gjuhën popullore, sh. Bul. për Shk. Shoq. IV (1953) 35. Te *bairimagë*, në Mirditë *bermagjë* (me gj për g në këtë dialekt) e te *brimaje* (Cordignano 2 462), Manni *birimagë*, ka pasur më fort një disimilim *m : m* në *b : m* në distancë sesa një huazim nga *βέρμαξ βόρμαξ* që jep Heziku. Arcm. *merimagë*, *merimagë* luron prej shqipcs, Papahagi 678.

metale f. "grumbull bore". E ka Fjal. i gjuhës shqipe. Përdoret në anët e Kolonjës, më fort në shumës. Si fjalë e toskërishtes, nga një bullg. *metalo*, prej *metam* "hedh", pra "e hedhur"; khs. shprehjen *hedh borë* "bie borë". Fjala bullgare i përgjigjet rus. *metelъ* "tufan bore", ukr. *métil* "stuhi me borë", të cilat Vasmeri (REW II 126) bashkë me sloven. *snég méte* "bie borë" i afron me rus. *metu* "fshij". Në çdo rasë *metale* hyn në ato sllavizma të shqipes, të cilat nuk ruhen më në gjuhët sllave jugore, po vetëm në ato të jashtë-Balkanit. Sh. për to Jokl, Sbornik Miletić 118-146.

metéh, *metef* m. "kufi, vend i lartë"; *metefe* f. "tërthore; eparki, dioqezë". Fjalë e geg. veriore (Malsi e Madhe, Mirditë), që shënohet te Gazullí. Nga gr. *μετόχιον* "pasuri manastiri, vakf, manastir, kuvend", që ka shkuar dhe në gjuhët sllave të Ballkanit, në rumanishten e gjer tej në rusishten. Për këto gjuhë khs. Berneker II 40, Mladenov 295, Vasmer REW II 126. Prej Toskërie i përgjigjen emrat e katundeve *Metohu* në Mallakastër e *Metojë* në jugperëndim të Beratit. Me tjetër theksim, nga gr. *μετοχή*, rrjedhin emrat topike *Metoqi* (afër Sarandës) e *Metohija* (afër Kelmendit, sh. Fishta HD XI 249). Përhapja e fjalës dhe në Veri flet për një huazim mjaft të vjetër; gjithsesi fjalë e periodës bizantine, e manastireve mesjetare; khs. *guman*, *ikonë*, *jerm*, *kallogjër*, *manastir*, *mitër*, *potir*, sh. dhe *Mëhill*. Asgjë nuk na shtyn të pranojmë me Selisçevin (f. 254v., 264) një

ndërmjetësim sllav te emrat topike të tipit *Metoh*. Për geg. *meteh metef* ekziston ndërkaq kjo mundësi. Veçse këtu gjan të ketë ndikuar dhe fjala *teh. tef*. Rum. *metoh* merret si një element grek hyrë nëpërmes të sllavishtes, sh. Rosetti, *Influenta* 44., *Istoria limbii romine* III⁴ 59.

mëgashër f. "Salvia officinalis, sherbelë". E dëshmon Weigandi 54 për Shqipëri të mesme. Prej lat. **medicaster*, Jokl LKU 212. Sh. dhe Walde-Hofmann II 471. Është një nga ato fjalë (o forma) latine që ruhen vetëm (ose pothuajse vetëm) në gjuhën shqipe. Shqipja ruan dhe një tjetër emër latin të kësaj bime, *sherbelë*. Sh. dhe *Revue de Linguistique* VII 1 191, 197.

Mëhill, emër burrash, i mbarë gjuhës në këtë trajtë. Del sëpari si emër shenjt i *Shenjtë Mëhill* në Litanitë e mëdha, te Buzuku XVIIIa (Budi RR 225 e ka latinisht). I shpeshtë dhe në dokumentet mesjetare renditur në *Acta Albaniae* I 275; veçse te këto çfaqet në trajtën latine *Michael*, e cila nuk tregon gjë për trajtën vendëse të emrit; ose në trajtën greke *ὁ Ἀβραμίου* (rreth vitit 1337, poaty 156). Rron dhe në *shëmhill*, emri popullor i nëndorit, sh. dhe G. Meyer 404 te *shënjt*, e për gjuhët romane Meyer-Lübke REW 5560/2. Gjurmët e kultit të këtij shenjt, të cilin kisha katolike e lut më 25 shtator, e ortodoksja më 8 nëndor, ruhen dhe në toponomastikë: *mali i Shën Mëhillit* në Zadrimë mbi Nënshat (G. Gurakuqi HD III 421). Në Krrabë është katundi *Shinmhill*, në Çermenikë *Shmil*.— Në Shkodër e në gjithë Veriun përdoret dhe hipokoristiku *Hilë*, sh. Buseti 1143.— Vjen nga gr. *Μιχαήλ*, që ka shkuar dhe te Sllavët e Ballkanit e te Rusët (sh. Vasmer REW II 140). Një mbeturinë e ndikimit të kishës bizantine në Shqipëri, që ruhet dhe në të tjera emra personash nga emra shenjtorësh, sh. *Llesh, Mitër, Qurk, Todër*. Sh. për historinë e këtij ndikimi Šufflay Illyr.— alb. Forschungen I 194v., 199, Jokl Balkan-Archiv IV 209, Balkangerm. u. German. im Albanischen 111v. Kemi të bëjmë me një ndikim që shkon nga shekulli i VIII. gjer te i XI-i, po që ka lënë gjurmë gjer te literatura e vjetër e Veriut e gjer më sot. Sh. edhe Bul. për Shk. Shoq. 2 (1957) 125, Bibliotheca Classica Orientalis. Të kësaj periode janë dhe emrat vetiake që u përmendën më sipër. Te *Mëhill* nga *Μιχαήλ*, shihet ndrimi i *i*-së greke në *ë* në silabë paratheksore dhe hifereza e *a*-së përpara *i*-së së silabës fundore në gjuhën shqipe: ndryshime që flasin për një huazim. relativisht të vjetër, pikërisht të periodës që u përcaktua më sipër.

mëkát m., **mëkatë** f.; **mëkatës**, **mëkatár**, më e vjetër **mëkatnuer**, **-ori** m. "ai që bën mëkatë"; **mëkatój** **mëkatnój** "bëj mëkatë". Nga lat. *peccatum*; khs. Miklosich Alb. Forschungen II 605, G. Meyer 271, Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1051, 1054, Puscariu EW 1234, Weigand 54, Tagliavini 180.

Pranë **mëkát** **mëkatë** (edhe **mukát** **mkat**) ekziston (te Budi DC 200a) **mkat**, te Bogdani (e në dialekt të Greqisë) **mpkat**. Bardhi ka *Peccatum Mkat*, *Peccare Me u përmtaturë*. Më me rëndësi është që te Buzuku e në disa ligjërime periferike të Veriut e të Jugut fjala paraqitet si *kat*: Buzuku (p.sh. Luka 15,18) *Atë, u rãe ndë kat mbë qiell e përpara faqesë sate* "Pater, peccavi in caelum, et coram te". Pokështu në një ligjërim shqiptar të Istriës nga shekulli i kaluar *Tata im ko voit nekat me ciel, e kontra tatas tem* "Pater, peccavi in caelum, et coram te" (Bartoli, Studi albanesi I 7-8, fotokopje), te vëllezërit Spiridhon e Anastas Çelo prej Gjirokastre aty nga fundi i shekullit të XVIII.: *Tatë, ukatërova prej qiellit edhe prej ti* ((Nahtigal, Arhiv za arb. starinu II 105); te Hahni (Fjalori 222) *katëronem* "bie në mëkat". Mbi këto dëshmi prej shumë degësh dialektore grafia *quat* e Buzukut do të lexohet *kat* (me *qua-* për *ka-* si *kartë*, sh. dhe *kaçile*), e jo (me

Joklin, në leksione) *quat* dhe e afër me gjerm. e lartë të mesmen *quat*, gjerm. e sotme *Kot* "shtazë e ndytë, ndytësi", angl. e mesme *cwéd* "i keq, i shëmtuar, i zvenuem", pra një huazim nga langobardishtja në shqipen, si fjala *farë*. Kështu lat. *peccatum* paraqitet me reflekset *kat*, *mpkat*, *mëkat* *mkat*. Zhvillimin fonetik Meyeri me shënimin e një faze të ndërmjeme *mbëkat* dhe me afrimin e rum. *păcat* duket se e ka menduar me shkallën **pëkat*: *mbëkat*: *mëkat*; afërsisht ashtu dhe Meyer-Lübke, me shkallën *p*:- *mp* (*mpkat*) : *m*- ose *pk* : *mk* që vendos ai. Ky mendim është në përgjithësi i drejtë: *peccatum* : **pëkat* : *mpëkat* *mpkat* : *mëkat*; *kat* nga **pëkat* **pkat*, me thjeshtim të grupit *pk* në *k*.

mëlcoj 'bëj të ëmbël, ëmbëlsoj'; *mëlcohem* 'ëmbëlsohem'. G. Meyeri 282v. sheh burimin e kësaj fjale të një lat. **mellitiare*, prej *mellitus* "i sheqeruar". Me të drejtë Jokli (LKU 212, 287v.) e lëfton këtë etimologji, e cila mbështetet më një bazë latine që nuk dëshmonet as për latinishten as për gjuhët romane. Ai gjen aty një verbum denominativum të *mjalte*-it, formuar me sufiksin *-(ë)soj* si *kripësoj*, *egërsoj*, *bukursoj*. Mendim që e pëlqen dhe Pedersen, *Philologica* II 111.

Fakti që përveç *mëlcoj* në toskërishten dëgjohet dhe *mbëlcoj* dhe që kuptimi i mirëfilltë i fjalës është "bëj të ëmbël", shpie në bindjen që *mëlcoj* është *ëmbëlsoj*, me aferezë të *ë*-së e me fortim të *s*-së në *c* pas likuidës *l*, khs. *malsi malci*. Edhe të një tjetër denominativ i fjalës *ëmbël*, të *mëltoj* "zbut (një pemë, duke e shartuar)", shihet i njëjti asimilim i grupit *mb*-si të *mëlcoj*, sh. *ëmbël*. Khs. dhe *malcoj*.

mëllagë, *mullagë* f. "Malva officinalis", *m. uji* "Althea officinalis". G. Meyeri 271 e spiegon nga gr. *μαλάχη*, po vërtet nuk lë pa vënë re se *g-ja* për gr. *χ* është e çuditshme; sh. dhe Tagliavini 193.

Del sëpari të Bardhi: Malva *Mëllaga* ò *mllaga*. Në Contessa Entellina (Siqeli) *mulltag* është "morth", emërtim i sëmundjes pas barit që përdoret për shërim të saj. Shq. *lakën lakër* nga *λάχανον*, *mokën mokër* nga *μηχανή* *μάχανά* tregojnë qartë si pasqyrohet *χ* në huazimet e shqipes nga greq. e vjetër. Prandaj *vargër* e *mëllagë* kanë vërtet lidhje me gr. *βάρηχοι* *ἄρνες* *Λάκωνες* e me *μαλάχη*, po jo si huazime të këtyre. Gr. *μαλάχη* me lat. *malva* "mëllagë" i nxjerrin përgjithësisht nga një gjuhë jo-indoeuropiane e Mesdheut. Prej këtij burimi rrjedh dhe *mëllagë*: sh. *Revue de Linguistique* VII 1 184, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. *Seria Shk. Shoq.* 4 (1962) 125, 141. Fjala e shqipes ndërkaq me *-g-*në e saj flet në të mirë të një baze **malghuā* ose **malaghuā* që shtron Kretschmeri (Einleit. in die Gesch. d. gr. Sprache 164) për fjalet greke e latine, e dëshmon më sakt për një **malághuā*. — Tosk. *mullohë* vjen nga gr. e re *μολόχα*.

mëllenjë, *mullinjë*, *mëllinjë*, *mëllëjë* f. "Turdus merula"; gegërisht edhe *mullizezë*; *mullinjë* e *bardhë*, *mullinjë* e *bardhë*, *mullibardhë* f. "Turdus musicus". Fjalë me etimologji të diskutuar. Sticri (Nr. 90), duke u nisur nga emërtimet e këtij zogu si "zog i zi" nëpër gjuhë të ndryshme, sheh burimin e fjalës të një gr. dialektore *μελάγιον* "e zezë", njëkohësisht duke lëftuar çdo afrim me lat. *merula* "mëllenjë". Me gr. *μέλαινα* "e zezë" e përqs fjalën dhe Kamarda (I 45), veçse nuk shprehet për karakterin e kësaj afërie, a farefisni apo huazim i shqipes prej greqishtes; nga gr. e vj. *μέλαινα* e spiegon Schuchardt (KZ 20, 207). Te lat. *merula* kthehet G. Meyeri 271, duke çuar *mëllenjë*-n (që e shkruan gabimisht me *-l-*) të një **mer(u)lanea*. Këtë bazë latine pranojnë dhe Pedersen (KZ 33,537) e Jokli (Rev. Int. d. Et. Balk. II 71); përkundrazi Weigandi 58 nisat nga një lat. **merlōnia*, duke sjellë për krahasim rum. *merlói* nga **merlonius*. Vasmeri (Studien I 42v.), duke u nisur nga fakti që ky zog edhe në nordishten e

vjetër e ka emrin nga ngjyra e zezë e pendëve, sheh të *mëllënjë* një fjalë vendi të shqipes, refleksi i një **melania* dhe e afër me gr. μέλας μέλαινα, ind. e vj. *malinā-h* "i ndytë, i zi", lit. *melynās* "i kaltër" lat. *melns* "i zi" etj. Tagliavini 199 kthehet te etimologjia latine e G. Meyerit.

Fjalë e mbarë gjuhës; del që te Bardhi: Merula, merlo *Mëllinja*, *o mllinja*. Në Malsi të Madhe pas Gazullit dhe *mëlli-ujce*, emër i një shpendi detar. Kundra burimit latin flet rrethana që një **mer(u)lana* e rindërtuar nuk del gjëkund, as në traditën latine as në gjuhët romane, sh. dhe Revue de Linguistique VII 1 192. Ajo as fonetikisht nuk i mjafton fjalës së shqipes, sidomos nuk arrin të spiegojë trajtën *mëllinjë*; vështirësi paraqet edhe trajtimi i grupit *-(u)l*.— Edhe nga **merlōnia*, bazë dhe kjo e rindërtuar, nuk arrihet te *mëllënjë mëllinjë*. As një burim grek nuk ka të gjarrë: jo vetëm sepse gr. μέλαινα me akcentin e saj nuk mund të jepte *mëllënjë mëllinjë*, po edhe sepse nuk është afër menç që shqipja të ketë marrë një fjalë greke me kuptimin e përgjithshëm "e zezë" për të formuar me të emrin e mëllënjës; me gjithë se nuk mungojnë të tilla rase, rruga e zakonshme është që të merret emri i shtazës ashtu si është. E drejtë mbetet etimologjia e Vasmerit, sepse formalisht e kuptimisht e patëmetë. Në të mirë të saj flet tani dhe rrethana që *mëllënjë* do të thotë edhe "dhi e zezë", e cila vërteton se kuptimi thelb i fjalës është "i zi", "e zezë", në Breg të Detit edhe *çjap i mëllënjët* "e. i zi" (M. Totoni). Vetëm se trajta e vjetër e fjalës shqipe mund të jetë *mëllinja* e Bardhit dhe kështu baza e asaj fjale të jetë **melinia*, me *-inā*. Këtë sufiks e gjejmë dhe te *dëllinjë*. Mund të ketë një afëri të veçantë midis *mëllinjë-s* dhe emrit keltik të këtij zogu: kymr. *mwyalch* merula, turdus", korn. *moelh* bret. *moualch* "mëllënjë". Këtë fjalë që prej Pedersenit (Kelt. Gram. I 73) e këtej e afrojnë me lat. *merula* e gjerm. *Amsel* "mëllënjë", po tani do pasur parasysh konkordanca kelte-shqiptare. Për të tjera barazime pjesore midis shqipes e keltishtes sh. *bërshë*, *dredhëz*, *mat*.

mëllezë f. "Ostrya carpinifolia." Këtë fjalë, e cila mungon te G. Meyerit, e jep Kristoforidhi për Përmet, bashkë me variantet *mëllënjë mullenjë*, si emër të një druri të afër me vidhin. Sipas Joklit (LKU 193 vv.) afrohet me lit. *mulvas* "i kuqremë, verdhak", let. *melns* "i zi", gr. μέλας "i zi", lat. *mulleus* "i kuqremë, i purpurtë", ind. e vj. *malinā-h* "i ndytë, i zi" etj. Mendim i pranuar te Waide-Hofmann II 123, te Pokorny I 721 e te Hofmann GEW 195, sh. edhe Fraenkel 431. Brenda shqipes Jokli e lidh fjalën me *mye*, *molikë*, *mëllë* e *mjerë* (sh. këto).

Fjalë e mbarë gjuhës. Gazulli jep për Malsi të Madhe trajtën *mbëdhexë*, Mitrushi 331 për Krujë *mleze*, për Shpat *mullezë*, për Berat *mëllezë*, për Mokër *mëllezër*. Ky emërtim i një lloj druri nga ngjyra e mbyllët e lëndës së tij, me afrimin e drejtë etimologjik që jepet për të, me dy format *mëllënjë* e *mullenjë* na del në thelb një me emrin e zotit *mëllënjë mullenjë* e me *mëllënjë* "dhi e zezë". Baza kuptimore e përbashkët është "i zi, e zezë". Për savoj. *melze* frgj. *mëlleze* "Larix" te Meyer-Lübke REW 5481a, Bertoldi Silloge ling. Ascoli 515, 540 shën. 129, Jokli mendon një burim prej ilirshites alpine. Khs. tani dhe Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 120, 137.

mëllë-ri mullā m. "bullungë në trup të njeriut a të shtazës"; tangë, siklet, brengë": *më mbeti mëllë* "më mbeti tangë"; *m'asht bā mullā në zemër*. Kjo fjalë te G. Meyerit paraqitet e shpërndarë në tri vise: f. 53 afrohet me *bulë* e *bullungë* e spiegehohet prej një lat. **bullana* të supozuar; f. 283 *mëllë* "μνησικαία" e Mitkos përçaset me kal. *mjel* e me *mjerë*; f. 825 *mollān mullān* "mall, maraz" spiegehohet nga it. *malanno* "mynxyrë; sëmundë". Pedersenit (KZ 33, 539) me të drejtë bashkon më një format

mëllë "bullungë" e *mëllë* "μνησικακία" dhe kundërshton për këto një burim nga lat. *bullā*. M'anë tjetër Helbigu (f. 28, 85, 123) për *mollan mullan* e te Junggu *mullā* "tmore, crepacuore" pranon spjegimin e G. Meyerit nga it. *malanno*, ven. *malan*. Bariçi (Arhiv za arb. starinu I 145) e zbërthen fjalën në *më-llā* dhe aty këtë *-llā* e afron me *lungë*, duke e çuar të parën te një bazë **ulonos*, të dytën te një **u^ln-g(h)ā*. Kundërshtime te Jokli (IJ X VII 67). Ky dijtar (LKU 195 e te Walde-Hofmann II 123) *mëllë mullā* bashkë me *mëllenjë mëllezë* "Ostrya carpinifolia", me *molikë* "Pinus peuce", me *mye* "zemra e drusë" e me *mjerë* e shpie te rrënja indo-eur. *mel-* "i zi", duke e afruar kështu me ind. e vj. *malinā-h* "i ndytë, i zi" lit. *mulvas* "i kuqremë, verdhak", let. *melns* "i zi", gr. μέλας "i zi", lat. *mulleus* "i kuqremë, i purpurtë" etj.; në këtë grup ai më parë (Studien Sv). kish venduar nga shqipja fjalën *blozë*. M.E. Schmidti (KZ 50, 236) edhe ai — ashtu si më parë G. Meyerit—*mëllë mullā* e afron me *bulë* e me *bullungë*, duke e çuar atë te një bazë **bhulon*, e cila sipas tij dha **bullān* **llan* **mlan* e mënfund *mullā mëllë*. Treimeri (Slavia III 545) e bashkon fjalën me *mall*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Në Martanesh ka formuar dhe verbin *spllahem* "qis mullanin, nxjerr inatin", me një zhvillim fonetik afërsisht nëpër shkallën **smullahem* **smlahem* **smpllahem* e me prefiksin antonimik *s*. — Çështja e etimologjisë së fjalës lidhet ngushtë me punën e kuptimit të parë të saj. Ndërsa Jokli thelbin kuptimor e gjen te të irunit e mëllërit, për ne fjalët që shënojnë një bullungë e njëheret edhe një vuajtje morale, një hidhërim, një brengë, kanë dalë më të shumtën prej kuptimit konkret të së enjturit, khs. *brengë*, *bolbë*. Prandaj *mullā* "kokrrizë, vizë qi spikon jashtë vizës së drejtë e së dëjun" te Gazulli e Me 'i *mullā*, sa 'i *grusht*, m' *njan faqe* (Fishta, Labuta e Malcis, Gjaku i marrun, HD XI 246) janë primare ndaj *Nji mullā ti në zëmër kë* (Deli Mehmet Aga, HD XII 238), ndaj *me shfrj mllānin e zēmers* "1. tuj i ardhë hakut kuj; 2. tuj i zblue zemrën kuj" (A. Sirdani, Leka IV 52) e ndaj *e ndë kanë mëllë mbë mua* për "inat, zemërim" te Mitko 172. Prandaj me *mullā mëllë* lidhet edhe *mllëf* "zemërim, inat i madh, mëni" (sh. këtë fjalë); khs. edhe shprehje të tilla si *me zëmër pak si të frjtë*; *zëmra e frjtë pëlset sjt*; *zëmra e frjtë then kryet* te A. Sirdani, Leka VI 151, 168. Kështu *mullā mëllë* është augmentativi më *-an* (sot geg. *-ā*, tosk. *-ë*) i fjalës *mullë* "bark, stomak"; khs. për formën *shullā*, *shullë* *shullëri* nga lat. *solanum*. Kjo gjen vërtetimin e saj dhe në këtë që *mullā* e *mullë* vise-vise janë sinonime; kështu në Shkodër *më dhemb mullani*, gjetkë *më dhemb mulla* "më dhemb barku, stomaku". Për zhvillimin kuptimor *bullungë* — *bark*, *stomak* khs. p.sh. lat. *guttur* "fyt, gushë, mëllë në qafë" — got. *qiPus* "stomak, bark". Për kuptimin konkret e abstrakt të *mullānit* khs. dhe it. *mi rincesce* "më vjen keq": *crescere* "me u rritë" e të tjera, te Meyer-Lübke REW 4363. Të tjera paralele te Janzén, Z.f. slav. Phil. 15, 57v. 59. Emri *mullë* zgjeruar me sufiks dha tosk. *mëllë mëllëri*, geg. *mëllā mëllani*, me *-ë*, te Budi (SC 137) *veçëse me paguom mëllānë mbë disa*. Trajta *mullā mullëri* e ka *-u-në* nga një ndikim i *mullë-s* ose nga një labializim i *ë-së* pas labialit *m* në silabë para theksit.

mëngër(ë) *mangën* f. "vegël për të rrahur lirin", po tosk. *mëngër(ë)* *sidomos* "vegël për të shtypur ullinjte". G. Meyerit (f. 259, 272) *mëngërë* e spiegon nga gr. e re μάγγανον, e geg. *mangën* nga një lat. **macca* lidhur me *maccare* "me shtypë, me shtrydhë". Sikundër ka treguar Jokli (If 36, 250; 44, 24vv.), *mangën* e *mëngër(ë)* janë forma dialektore të një fjale të vetme, kjo refleksi i gr. së vj. μάγγανον "bosht i çikrikut, maqinë hedhëse", sot në Epir μάγγανο "mëngër për të rrahur lirin". Verbi

manganis "lënur leshin; shtyp në tork" nga gr. e re μαγγανίζω, G. Meyer 272, Pedersen 154.

Forma geg. *mangë* më fort se një nominativ i ri ndërtuar pas akuzativit *mangën* (Jokl) do të jetë përfundimi i një apokope, shkaktuar nga puna se *mangën* u ndie si një plural më -*ën*. Kështu spjegohet dhe *drap* për *drapën*, *dhelpe* për *dhelpën*, tosk. *qepë* për *qepër*, *kudh* për *kudhër* etj., sh. Li. Posn. VII 182; janë të gjitha singulare të shkurtëra, të dala prej singularesh së plota marrë gabimisht për plurale më -*ën -ër*. — Historikisht *mangën mëngër-(ë)* bën pjesë në grupin e huazimeve të shqipes nga greq. e vjetër në fushë të veglave dhe enëve, si *kandër* e *shtamë*; sh. dhe Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 130, 145. Mbi dëshminë e mbeturinave të fjalës greke në greqishten e sotme t'Italisë jugore (te Rohlf's EW 1291) mund të mendohet që apul. *manganiedde* "manganis" (te Meyer-Lübke REW 5297) të jetë një relikto drejtpërdrejt nga greqishtja e Magna Graecias. — Sh. edhe *mëngji* e *mengjene*.

mëngji f. "mjekim me prime; magji"; *mëngjis* "njekoj me prime", *mëngjises* "mjekohem me prime"; *mëngjistár* m. "magjistar", fem. *mëngjistare*. G. Meyer 253 e vë baras me *magji*. Jokli (IF 44, 24vv.) e lidh brenda shqipes me *mëngër(ë) mangën* nga gr. μαγγανον., e cila në greq. e vjetër ka dhe kuptimin "magji, prime".

Del në këtë formë që të Budi (DC 225, SC 9 etj.): *As me gjetunë mëngji*, verbi *mëngjis* p.sh. DC 89 *me ja shëndoshunë e me ja mëngjisunë*, RR 337 *e me mëngjisunë plagëtë e vet*. Buzuku e Bardhi e kanë *mjegia*, i pari me grafiminë *mie k. ia*, i dyti Medicina *Mieghia*. Te Buzuku del dy herë (LIX/2, =LXI/2, Oratio, LXXV=LXXXV, Oratio=Postcommunio): *e të miratë e tyne u klofshinë për mjegj të shpirtit* "medicinalis parcimoniae studio reformatur"; *Mjegia e zotënisë sate* "Tua... medicinalis operatio". Bardhi Medela, Medicina *Mjegia*. Bogdani ka dy trajta, *mëngji* e *mjekji*: *Për një mëngji pra të kaqa nevojtëve* "Per rimedio dunque di sì estremi bisogni", *ma tepërë të Mjekjvet* "massime delle Medicine" (I 83, 15; II 47.5). Nga këto shihet se fjala etimologjikisht është *mjekji*, një zgjerim i *mjek*-ut me -*i*, e cila me sonorizimin e okluzivitetit të silabës fundore në geg. e Veriut dha *mjegji*-në e Buzukut e të Bardhit. Kjo me epentezë "popullore" të një *n*-je u zhvillua në *mëngji* e në *mëngji*, duke ndërhyrë edhe fjala *magji*. Kështu *mëngji* nuk është *magji*, po ka pësuar vërtet një ndikim nga kjo anë, prandaj edhe *gj-ja* e saj. Prej *mëngji*-së erdhi e sotmja *mnji*, si *mnjille* prej *mëngjille*, me zbutje të grupit *ngj* në *nj* në gegërishten. Këtë bashkë me epentezën e -*n*-së e vuri re dhe Pedersen (KZ 33, 536), veçse përndryshe i mbahet etimologjisë së G. Meyerit.

mënjollë f. "fidan". Pas G. Meyerit 274 prej lat. *malleolus* "përpajnë, fidan", me anë të një disimilimi. Pokështu Pedersen KZ 33,542. Për punë të mungesës së diftongimit të *o*-së e të përhapjes dialektore të fjalës ka më gjasë që kjo të jetë it. *magliuolo*, me *nj* si në milan. *maño*". Ose nga ven. *magliolo*.

mërenë, *mrenë mërengë* f. "emër peshku, *Mulus barbatus*". Mungon te G. Meyerit. E ka Arbanasi si *mrenë* "Barbe", Manni jep dhe *mërengë*. Pas Mannit (f. 282, 296) nga sllavishtja (serbokr. *mrena*) e kjo prej greqishtes (*μούραινα*).

Ekziston dhe trajta *murenë*. Mund të rrjedhë drejtpërdrejt nga lat. *mureena* (e cila ka kaluar dhe në gjermanishten, si *Muräne*), ose nga it. *morena*; *mërenë* : *mrenë*. Rum. *mreana* rrjedh prej bullg. (së vjetër) *mrena*. Meyer-Lübke RE W 5754, Rosetti Influenta 60, Ist. li. romine III⁴ 91

mërkurë (e) f. Nga lat. *Mercurii* (*dies*), Miklosich Alb. Forschungen

nga një elipsë, duke mbetur jashtë te *mëshere djathi* fjala e dytë. Në pikëpamje formale *mëshyer* qëndron në një shkallë me geg. *mëshërier mishërier*, duke ndryshuar nga kjo vetëm në labializim të *i-së në y* te diftongu *ie* e në zhdukje të *r-së*. Është një trajtë më e vjetër se e sotmja *mëshirë*. — Trajta *mushere* tregon errësimin e *ë-së* në *u* në silabë paratheksore, dukuri e shpeshtë sidomos në afërsi të një labiali, siç është *m-ja* këtu.

mështekër mështekën f. "Betulla verrucosa". Kjo fjalë e mbarë gjuhës mungon te G. Meyeri. Trajta dialektore te Mitrushi 340. Nga këto, *mushtekër*, -n paraqet ndrimin *ë* : *u* në silabë paratheksore, pranë labiali; *shtekën* në Vuçitern ka dalë nga shkëputja e *më-së*, që u ndie gabimisht si prefiks. Si e kemi shtjelluar dhe në Li. Posn. VIII 91v. e në Revue de Linguistique VII 1 182, kjo fjalë afrohet etimologjikisht me rum. *masteacan* që është emri i pokëtij druri. Këtë Tiktini II 970 e pat nxjerrë nga një lat. *masticinus* prej *mastix*, për punë të lëngut që del prej trungut të mështeknës; përkundrazi Diculescu (Dacoromania IV 478), me pëlqim edhe të Meyer-Lübkes REW 5398b, e qet drejtpërdrejt nga gr. *μαστίχινος*. Në të vërtetë fjala e shqipes rrjedh prej greq. së vjetër, nga një (*δένδρον*) *μαστίχινον*, e fjala rumune pas gjase prej shqipes; sh. tani Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 130,145. Fjala greke rron sot në italishten e Siquelisë si *mastigona* "Atractylis gummifera", sh. Rohlf's EW 1338. Trajta *mushték mështék* te Bariçi Reçnik 63 e te Mitrushi është një singularizim i padrejtë, duke u marrë *mështekër*, -ën në ndjenjën gjuhësore gabimisht si plural.

mëtrik m. "kolik, sëmundje e bagëtisë". Mungon te G. Meyeri. E ka Bashkimi 535 si *mtrik* m., pl. *mtriqe* "cancrena interna allo stomacho od altre parti. Sorta d'animale in forma di granchio che si crede che roda gli intestini". Me këtë ne bashkojmë *mertik* "lëngatë bagtish pëllezja: *i ka ra mertik bagtis*; mandej *bar mertikut* "Aristolochia angustifolia" (*petrik*), *mertik* "Ricinus communis" te Gazulli (f. 261, 495), te Fjal. i gju. shqipe *mëtrik* "Vinca minor" *mërtik* "ricinë", duke parë te *mertik mërtik* një formë metateze; hyn aty dhe *mitriq* "grip, kolik, i fëmijve" që jep Ed. e Re për Myzeqe. Të gjitha këto forma: *mtrik mëtrik mitriq* e *mertik mërtik* janë refleksi i lat. *matrix matrice* "mitër, ani i fëmijës", e më saktësisht i një lat. (ballkanike)* *matrica* që mendon me të drejtë Puscariu EW 1051 për arom. *matrica* "enjë" sard. e vj. etj. *matrika madrigga*. Sidomos *mitriq* piqet në kuptim me rum. *matrice*, që do të thotë dhe "të prera barku ndër fëmijë të vegjël". Kjo fjalë është i dyti refleksi i lat. *matrix matrice* ose "matrica në gjuhën shqipe, sh. *ndrikull*. Për emrat e bimëve do pasur parasysh se këto përdoren si mjekim kundra dhembjeve të barkut, pra e kanë marrë emrin prej sëmundjes që mendohet se shërojnë (sh. *mëllagë*). Shprehja e ndërmjeme midis emrit të sëmundjes dhe emrit botanik është *bar mertikut*, ku pastaj *bar* mbeti jashtë me anë të një elipse.

milák m. "këlysh lepuri, kaçorr; fëmijë gjer në dy vjeç". G. Meyeri 278 e përqs me *milor*, fjalë me gurrë rumune. Për Pascun (Rum. Elem. i. d. Balkanspracher 65) është rum. *mel* "qengj" + *-ak*. Jokli (IJ XI VII 190) vë re këtu mungesën e një arsytimi të anës kuptimore.

Ka lidhje me gr. e vj. (nëpër mbishkrime) *μέλας* *υέλλακος* "djalë i ri", *μέλακες νεότεροι* te Heziku. Te Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 130, 145 e kemi marrë si një huazim të shqipes nga gr. e vjetër. Ndërkaq do vënë re se fjala greke vetë është e errët në punë të burimit, sh. Boisacq 624.

mitë f. II "filiz që del rreth kërcurit të një druri të prerë", në Sh. Gjergj të Tiranës (dhe te Fjal. i gju. shqipe), në Malësi të Tiranës "një e dalë në drurët"; në Xherie të Dumresë *mitër* f. "bisk i vogël i të lashtës,

që ka mbetur i rrëgjuar", me $-(\ddot{e})r = -(\ddot{e})rr$ deminutive. Është një me *mitëz* "drenushë" te N. Frashëri (Ist. e Skënderbeut 50): *Si një mitëz e vënitur*, e m'anë tjetër me *kacamitë* (*kaca-mitë*) "drenushë" në arbërishten e Italisë (sh. *kacamitë*). Si në të tjera gjuhë, edhe në shqipen suta (*drenushia*) e ka emrin nga brirët e vegjël që ka ose nga të mospasurit brirë; kështu edhe *sutë* lidhet me *shyt* (sh. këto dy fjalë). Për *mitëz*, —*mitë* (*kacamitë*) "drenushë" e *mitë* "filiz rrënje" me *mitër* "bisk kalliu" khs. p.sh. *cerboni* "lozë ardhie" në Sardenjë: *cervus* (Meyer-Lübke REW 1850). Prandaj me *-mitë* e *mitëz* "drenushë" lidhet edhe *gjuhë mite* "gjënb i hollë që bin nëpër livadhe" (Ed. e Re II, Ser. III, fruer 1931, f. 52), khs. frgj. *langue-de cerf*, gjerm. *Hirschzunge* (Scolopendrium). Etimologjikisht *mitë* afrohet me gr. *μίτυλος* "shyt, pa bri" (për dhitë) si një konkordancë parciale greko-shqiptare. Ndërkaq fjala greke, që gjindet te Teokriti (VIII 86), si një term baritor i dorishtes, mund të jetë një huazim parashqiptar (ilir) në atë dialekt; sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 127, 143. Për lidhjet e fjalës greke brenda greqishtes (me *μιστύλλω* "copëtoj mishin") e për afrimet e saj indoeuropiane khs. sidomos Boisacq 640v., Walde-Pokorny II 222v., Walde-Hofmann II 136v, Pokorny I 697, Hofmann GEW 203.

Mitër, *Mit*, emër burrash. Trajtë e shkurtuar e *Dhimitër*, nga gr. *Δημήτριος*. Veriu katolik *Bitër Bitri*, sh. Busetti 1142, *Bitri* edhe emër familjeje në Shkodër e n'Elbasan, me zhvillim fonetik *m: mb: b*. Del si *Dimitri Albanensi* afër Raguzës më 1285, Acta Albaniae I 156; përndryshe në trajtën latine *Demetrius* (sh. poaty f. 266), që nuk jep gjë për trajtën vendëse të emrit. Ruhet dhe në *shëmitër*, emri popullor i tetorit (sh. dhe G. Meyer 404); emërtim pothuajse ballkanik: gr. e re *ἀγιοδημήτριος*, arom. *Samadrean* (Puscariu EW 1598) etj. Edhe *Mitër* hyn në grupin e emrave vetiake që burojnë nga ndikimi i kishës bizantine në Shqipërinë mesjetare; sh. për këto emra te *Mëhill*, e në Revue de Linguistique VII 1 182 shën. 1.

mizón "bie borë e hollë, qimton, fijen". Përdoret në Labovë të Madhe (Tepelenë). Denominativ i *mizë-s*. Për kuptimin khs. span. *moscas* "shkëndija", *moscas blancas* "flokë bore"; pikard. *povilyo de aëz* "flokë bore" ("flutura bore") te Meyer-Lübke REW 5766, 6211. Edhe në të tjera vise përdoren për "borë" fjalë që shënojnë miellin, fluturat, leshtë, sh. Debrunner IF 54,79.

mjedhër, *mjedër* f. "Rubus idaeus". Fjalë e mbarë gjuhës, po me forma dialektore të ndryshme: Shqipëria e mesme *mjedhër*, Veriu më fort *mjedër* (Dukagjini edhe *mider*, Malsia e Madhe *mjedër* e *mither*, Mati *mjedër*, te Godini *mjetërrë*, Vrinti i Dibrës me ndrim *mj: nj njetër*, Reka e Sipërme me monofongim *je: e medër*; sh. Jungg, Bashkimi, Jokl (Rev. Filologica II 257, IJ XX VII 93), Bertram HD VI 626, K. Gurakuqi Illyria I Nr. 17 f. 8, M. Harapi Të Fejuemit 44 shën.2, Mitrushu 122. Del që te Buzuku (IXL, Mateu 13,26) si kompozit pl. *manemjedhëra*: (*man + mjedhëre*): *Kur u rit drithëtë e zū me zanë frujt, ashtu atëherë u dëftuonë edhe manemjedhëratë* "Cum autem crevisset herba et fructum fecisset, tunc apparuerunt et zizania". Mungon te G. Meyeri. E paspieguar gjer më sot. Raporti fonetik midis trajtave *mjedhër mjedër mjetër mither* me variantet e tyre është i një-llojtë me atë që çfaqet midis *hudhër hudër hotër, badhër badër batër bathër*. E sikundër që këto shpie te *hurdhë* (e gjallë në kolonitë arbëreshe t'Italisë) e përkatësish te *bardhë* (sh. *hudhër, badër*), ashtu dhe *mjedhër* me format e saj shpie te një bazë shqiptare **mjerdhë*. Kjo ruhet gjer diku te *mjerdull* në Lunxhëri (Gjirokastër), sh. M. Totoni Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës

Sëria Shk. Shoq. 1, 1962, 210. Formuar, nga sa duket, me sufiksin kolektiv *-dhë* (sh. për këtë Jokl Studien 33, 47, LKU 187, 207v, 300), Xhuvani-Çabej Prapashtesat 31. Reflekton një bazë parashq. **mer-* **mer-dā*. E afër me fjalën keltike irl. e mesme *merenn* kymr. *merwydden* "man" e mbase edhe me gr. *μόρον* lat. *mōrum* "man", arm. *mor* "fermanzë; ose me fjalën keltike irl. *smēr smēar* kymr. *msvyar* pl. "fermanzë", korn. *moyr-brēn* "morus" bret. *mouar* "mora". Sh. për këto të fundit Pedersen Kelt. Gram. I 67, për të parat sidomos Walde-Pokorny II 306, Walde-Hofmann II 114, Pokorny I 749. Shqipja ka dhe një tjetër konkordancë me keltishten nga kjo fushë e florës: *dredhëz*.

mjegull, *mjergull* f. Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri (f. 283v., Ngri. Studien III 62) mendon si burim lat. *nebula*, po në një trajtë "*nebla* **nevla* **negla*, e duke pranuar mundësinë që një fjalë vendi, e afër me sllav, e vj. kishtare *mōgla* lit. *miglā* gr. *ὀμίχλη* "mjegull", të ketë ndikuar më të. Etimologji e pranuar vetëm te ndonjë romanist, si Puscariu (EW 1168), Weigandi 56 (me një ndikim të fjalës *mjerë*), Pascu (Archivum Romanicum VI 271). Shumica e gjuhëtarëve janë kthyer te gurrat autoktone të fjalës, veçse duke rrahur rrugë të ndryshme. I mendimit të një afërie me grupin e gr. *ὀμίχλη* është Brugmanni (Grundriss II, I² 362), poashtu si përpara tij Kamarda (I 70) e Diefenbachu (II 174). Jokli përkundrazi (Studien 57v., IF Anzeiger 35, 37) nisat nga *mjergull* dhe këtë e krahason me sllav, e vj. kishtare *mrakъ* (sllav. e përbashkët *mork-*), nord. e vj. *myrkr* "terr". Etimologji e pranuar të Bariçi I 105, Pokorny I 734, e te Cimochowski (Li. Posn. IV 202 vv.), veçse ky nisat nga një **mjerg* a **mjergē* zgjeruar me *-ullë* përbrenda shqipes; khs. dhe Walde-Pokorny II 247, Tagliavini 191. Te afrimi me gr. *ὀμίχλη* sllav. *mōgla* etj. kthehet përkundrazi Boisacq 701, La Piana (Studi ling. alb. I 114), Vasmer REW II 109. I rezervuar Fraenkeli 451.

Fjalë e mbarë gjuhës. Zgjerime me përhapje dialektore janë geg. *mjegulli*-f. e *mjegullinë* f., arbërisht e Italisë *mjegul* (l)-or; verbi *mjegulloj*, — Vështirësitë fonetike që shtyjnë Joklin të hedhë poshtë barazimin me grupin gr. *ὀμίχλη* sllav. *mōgla* lit. *miglā* etj. nuk janë të pakapërcyeshme. Forma *mjergull* nuk është paspiegueshme: -r-ja si konsonant shtesë është shpesh të nëpër dialekte, dhe *mjergull* është dialektore. Nuk është domosdoshme që një formë bazë më *-gl-* e kësaj fjale (si p.sh. *mjega*) do të kish përfunduar në *-gj-*; as edhe që te një bazë me *-g+vokal+ l* (si **mjegulā*) duhej të kish rënë *g*-ja intervokalike. Nuk ka rënë kjo *-g-* në një fjalë krejt analoge me *mjegull*, *tjegull* nga lat. *tegula*. Ne prandaj si bazë të fjalës (ashtu si La Piana) mendojmë një **megla*, me dy zhvillime fonetike, mjaft të lashta: diftongim i *e-së* në *je*, e — në pajtim me G. Meyerin — zhvillim i një *u-je* midis *l-së* e konsonantit që i prin, khs. *akull*, *avull*, *mugull* etj. te G. Meyer Alb. Studien III 80 (me gjithë kritikën që i bën Jokli LKU 267 vv.), mbase edhe me një ndikim analogjie nga ana e sufiksit *-ull*. — Trajta *mjengull* e shqipes së Greqisë përmban epentezën e një *-n-je* të së folurit popullor. Trajta tjetër *njegull* e geg. lindore ka dalë nga ndrimi *mj* : *nj*, i rregullt në atë dialekt. Ky ndrim fonetik bën pjesë në ato zhvillimet e vjetra të gegërishtes, për të cilat sh. vretjtet tona në Studii si Cere. lingvistica X 4 530v. Sepse prej *niëgullë* rrjedh rum. *negura* "mjegull", duke ndikuar te kjo, në punë të *-e-së*, dhe lat. *nebula*, sh. *njegull*.

mjetë f. "leshi i shkurtër që mbetet në fund, kur e zgjedhin leshin, dhe që shtihet në të endur si ind, e përdoret për hërruce". G. Meyerit 284 kjo fjalë i kujton frgj. *miëtte* "thërrime", prandaj - ndonëse me rezervë - mendon si bazë një lat. *micetta* "migetë", nga *mica* "thërrime". Kamarda

(I 44, 61) e afronte me gr. **μίατος** "majë e pëlhurës, timër".

Fjalë me një përhapje mjaft të madhe. Kristoforidhi e shënon për tos-kërishten, po pa i dhënë kuptimin, vetëm jep frazën *ky lesh është gjithë mjetë*. Ed. e Re (Ser.III, viti VII = I, Nr. 3, f.120) jep për Labëri *mjet-i* m. "lesh i tredhur trashë". Në Kuç të Kurveleshit *mjet* është leshi i trashësisë e gjatësisë mesatare, sinonim me *ind-in*, e mbeturina e leshit, *mjeta*, quhet atje *mjedhër*. Në Borsh *mjet-a* (pas M.Totonit) "filli tërthor që e mbush pëlhurën së gjëri, ind; filli tjetër quhet maj-a". Në Margëllëç të Çamërisë *mjetë* është indi, "filli i shkurtër në të endur", e kundërta e majës, atje *malë*. Fem. *mjet-a* në Elbasan shënon mbeturinat e leshit që ngelin në gërrhanë kur lënuret leshi. E ka dhe Gazulli (f.265,495) si *mjetë (leshi)* "inda leshi, fija e shkurtë, që hyn në punë për pë të shkurtën a ind pëlhure", po pa ubikacion. Del dhe në shqipen e Greqisë; në Megarë e në Salaminë *mjetë* është "leshi i shkurtër që mbetet si të hiqet maja më e mirë, **λαγάρα**, Furikis në **Λεξικογραφικόν Ἀρχεῖον τῆς μέσης καὶ νέας Ἑλληνικῆς** 6 (1923) 424v; kjo formë paraqitet me ndrimin *mj*: *maj* të atij dialekti, ndikuar nga greq. e re, për të cilin sh. Weigand, *Balkan-Archiv* II 203, 113.—Kjo fjalë me përhapje ndër-dialektore, term i vjetër i sferës së punimit të leshit, është substantivimi i participit të verbit *jes jeta* "mbetem", "ajo që jet, e jetmja", pra në thelb një me emrin *jetë jeta* (sh. këtë). Dallohet nga kjo formalisht vetëm në prefiksin *m-që* ka, *m-jetë*. Te atributi *leshi* që ka Gazulli si shtesë (*mjetë leshi*) ruhet edhe sot një gjurmë e natyrës verbale të fjalës, duke dalë kjo si "mbeturinë leshi". -Për mjetën M.Širdani (HD V 26) jep për Veri *kanë metë do metza e sheje të besimit të vjetër*, me kuptimin "mbeturina". Kjo është trajtë paralele me *mjetë-n*. Ndërsa kjo rrjedh prej *jes jeta*, *metza* ka dalë nga kompoziti i këtij verbi, nga *mbs mbeta*, participi *mbetë*, me asimilimin *mb*: *m*, pra "ato që mbeten". Trajta *mjedhër* e Kuçit paraqitet si produkti i singularizimit të pluralit më-*ra*, *mjetra*: *mjedra*: *mjedhra*. Po mund të ketë ndikuar dhe fjala *mjedhër mjedër*.

mlysh m. "Esox lucius, emër peshku". Hahni jep *mlyç* "lloj peshku i ujërave t'ëmblla", e G.Meyeri 284 kufizohet me shënimin që it. *merluzzo* është peshk deti. Te *mlysh mlyç*, të cilin pas Hahnit e ka Kristoforidhi, *y-ja* është vazhdimi i një *u-je* të gjatë. Kështu kjo fjalë shpie te lat. *lucius*, e për punë të silabës së parë më *m*- më fort te *maris lucius* që qëndron në bazë dhe të disa formave romane që jep Meyer-Lübke REW 5143; nuk përjashtohet ndërkaq që *m-* të jetë prefiksi i shqipes. Për kuptimin "budalla" khs. kat. *llus* "mlysh" e "budalla" e gjerm. *Stockfisch* "budalla" po te Meyer-Lübke. G.Meyeri (Ngri. Studien III 39) jep për greq. e re pas Legrandit një **λούκιος** "mlysh", po dyshon që të jetë një fjalë popullore. Tani shq. *mlysh* e gr. e re **λούκιος** mbështesin njera-tjetrën dhe flasin me mjaft gjasë për ekzistencën e *lucius* dhe në latinishten ballkanike.-It. *merluzzo* ka hyrë në shqipen si *merluc*.

mllëf m. "zemërim, inat i madh, mëni", *mllëfqâr* "inatçi, zemërak". Fjalë e geg. veriore, e cila mungon te G. Meyeri. E ka Bashkimi për "astio, rancore", *me ja pasë mllëf* "covare il rancore", Busetti për "astio, rancore, stizza", Godini për "Groll, mëni, idhnim". Nuk është gjë tjetër veçse një formë e fjalës *mullâ*. Ka dalë nga variantja *mllë mlleni* që ka Manni. Aty u zhvillua te trajta e shquar një *h* kundra hiatit (*mllëhi*), e cila u përgjithësua, duke u ruajtur dhe në të pashquarën: *mllëh*. Një i tillë zhvillim fonetik është i shpeshtë në geg. veriore, khs. *psehi, mesehe, kahja* etj. Me ndrimin *k*: *f* u arrit në *mllëf*.

morth m. "të enjturit, të skuqurit e të ngrënët e lëkurës në duar e në këmbë, e në vesh, shkaktuar nga të ftohtit". G.Meyeri 260 e lidh etimolo-

ndëmose "altrimenti". Këtu -e-ja është trajta e shkurtër (proklitike) e përemrit vetor t'akuzativit, ngjitur *mos-it* në ngërthim të fjalisë, në rasi të tilla si në *mos e do*, e përgjithësuar pastaj. Bardhi ka Nisi *Ndë mos-*. Trajta e thjeshtë *mo* rron te *moh* vohoj.

moshë f. ; *moshatár* "moc, vërsnik", fem. *moshatare*. Lidhet në radhë të parë me *mot*, e më tej, përbrenda gjuhës, me verbin *mat*, që ka një tjetër shkallë vokalike ; jashta shqipes afrohet me lit. *mētas* "kohë, mot, vit", lat. *mētiór* "mat" etj. ; sh. G.Meyer 263, Jokl LKU 33, Wörter und Sachen XII 79vv. Me fjalën e shqipes lidhet rum. *moš* "plak, gjysh", fem. *moša* "plakë, gjyshe", *mošie* "trashëgimi" ; sh. edhe Treimer Z.f. rom. Phil. 38,400, Scheludko Balkan-Archiv II 139, Puscariu Limba româna I 179, Rosetti Istoria limbii române II³ 102, 106, 116, Bariç Hýmje 166, M.Sala Studii si Cerc. lingvistice VI (1955) 140vv. Nuk ka dyshim që fjala rumune buron prej shqipes, sepse *moshë* këtu bën pjesë në një grup të tërë fjalësh, si *mot*, *masë* "brezní", sh. sidomos Jokl IJ XVIII VII 184, XXIV VII 195. Rëndësi të veçantë ka në këtë mes që te Buzuku *mot* përdoret dhe për "moshë", prandaj *moshë* nuk është veçse një variante e zgjeruar e *mot-it*, pas Joklit refleksi i një baze **mē t-si-*.

moshtrë f. "shëmtim ; krijesë e shëmtuar". E ka vetëm Budi (RR 21): *...kúr godit kori, e len kund ndonjë Moshtrë, e ashtu kafshë e shëmtuome: ... Moshtra qi as me ndonjë shinj nukë shemënjien me qenë nierç* (Bardhi ka Monstrum Çudim). Rjedh në analizë të fundit nga lat. *monstrum* që rron dhe në it. *mostro*, arom. *mostru* te Meyer-Lübke REW 5665a. Për punë të o-së së gjatë që s'u kthye në e (si te *pōmum* : *pemë*), fjala rrjedh ose nga lat. e vonë ose nga it. (o ven.) *mostro*, si huazim i vjetër, me ndrim të s-së në sh. Më e re është *mostër* (sh. këtë fjalë).

mpij, *pīj*, *mbij* "bëj të mpihet" ; *mpihem* *pihem* *mbihem* "nuk luaj dot një gjymtyrë të trupit" ; *i mpirë*, *i pītë*, *i mbirë*; *shpij* *shpīj* *çpij* "shtrij një gjymtyrë të mpirë të trupit" ; *shpihem* *shpihem* *çpihem* "shtrij gjymtyrët e mpira a të lodhura; më shkon të mpirët". G.Meyeri 265 nisat me të drejtë nga *m-pij* si trajtë bazë (ashtu më parë dhe Kamarda II 157), veçse spjegimi që jep ai nga gr. e re *πῆγω* "mbështjell, piks (qumështin)" nuk mund të qëndrojë : gr. e re *πῆγω ἔπηξο* ka dhënë në shqipen *piks*, siç shënon vetë Meyeri f. 337. Te *mpij* primitivi *pij* rrjedh nga një bazë **paġinio* dhe i përgjigje gr. *πάγος* "akull, ngricë" *πάχνη* "ngricë, çafë" *πήγνυμι* "mbërthej mirë, ngul ; e bëj të ngrijë", lat. *pango* "mbërthej ; ngul, ngërthej ; bartoj me shkrim", slloven. *páz* "ngërthim", gjerm. *Fach* etj. Sh. për këtë grup fja- lësh sidomos Boisacq 777v., Walde-Pokorny II 2v., Ernout-Meillet 721, Pokorny I 788 me literaturë, Hofmann GEW 267. Në këto rrethama afërie kuptimi i parë i fjalës shqipe duhet të ketë qenë "ngrij". Në këtë vështirim kjo afrohet më fort me fjalët greke, dhe mund të quhet një nga konkordancat e veçanta të shqipes me greqishten. Për një kuptim të dikurshëm "ngrij" dëshmon *i mpirë*, *i pītë* "i ngathët": *i ngrirë* "i ngathët", *fmi i pim zânash* "i mbaruem" (A Sirdani, Leka IV 158), në të vërtetë "që e kanë ngrirë zanat", te Lambertzi 126 *na mpiu e stohta* "na ngriu e stohta". Nga **paġinio*, me rënien e rregullt të okluzivit të zëshëm në pozicion intervokalik, u zhvillua idealisht një **pëinj* e s'andejmi *pinj*, e gjallë edhe sot në geg. *pij*, me *pī*. Preverbi *m-*, nga *en-*, formoi *mpinj*, duke i dhënë verbit një kuptim faktitiv, "e bëj të mpihet". Kjo trajtë çfaqet që te Buzuku (XLV, Ezekieli 18,2) : *Përintë tanë angrënë grestënë, e dhambëtë e d bijet u mpinë ?* "Patres comederunt uvam acerbam et dentes filiorum obstupescunt ?" Nga *mpij* u arrit me asimilim në *mbij*, trajtë e toskërishtes pranë *mpij*. Del që te Leake (f.333) : *tëbitë* "μούδιασμα, numbness" ; te Santori (Emira

skena V, te de Rada Antologia albanese 81) *më mbiyen lorët* "mi si intorpidiscon le braccia". Po ruhet *p*-ja kudo te opoziti *shpij shpihem* : Piana dei Greci në Siqeli *shpinj*, kështu shumëkund edhe në Shqipëri. Trajta me ç- ndihet dhe në gegërishten : *Për gojë gjaku ishte çpi* (Selcë, Vis. e Kombit II 101), *me iu çpi kujt gjaku* "me iu shgrehë gjaku" (Sik, Cirka III 287). Për sufiksin verbal *-inj* nga *-iniō* sh. *hyj hij, kij*.

mrekull m., *mrekull* f., Kavalioti *mbrekullim* m., *mrekullōj* "çudit, habit", *mrekullohem* "çuditem, habitem"; *i mrekullueshëm*. Spiegohet përgjithësisht nga lat. *miraculum*; sh. Miklosich Alb. Forschungen II 241, G.Meyer 288, Pedersen KZ 33, 536, Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1048, Weigand 57.

Fjalë e gjuhës kishtare, që njihet vetëm për gegërishten; meqë dhe në gjuhët romane nuk është thjesht popullore (sh. dhe Meyer-Lübke REW 5602), mbetet e dyshimtë a rrjedh prej lat. (së vonë) *miraculum* apo prej it. së hershme *miracolo*; megjithatë, për punë të metafonisë, më fort huazim latin se italian. Pavarësisht nga kjo, në shqipen e vjetër ruhet -ë-ja në silabën përpara theksit, sikundër tregon një vështrim i burimeve letrare e i dialekteve periferike: Buzuku (LIX/2 = LXIX/2, Danieli 3,43; XLII/2, Marku 6,52) *Shelbona në porsi mërëkujtë e tū të mëdhenj* "Et erue nos in mirabilibus tuis", *përse edhe ata s'kishnë patë mërëkullinë e bukëvet* "Non enim intellexerunt de panibus"; Budi (DC 11,56,SC 189) *Aqë si një mërëkull*; *me një zā, aqë fort të madh, e të mërëkulluoshim; t'ishnë mërëkulluom anco kafshe*; Bardhi *Miraculum*, *miracolo Mrekullë*, *Mirabilitas Mrekullia*, *Mirabiliter Mrekullisht*, *Mirificare Me bām mrekulli*, *Ostentum Të dëftuem o mërëkullë*, *Portentum Mërëkullë*; Bogdani (I 14, 13) *me u mbrekulluem* "per modo di maraviglia". Po e ka dhe Puljevski (për Rekë të Dibrës) *mërëkullija*, Bageri (f.II) po për Rekë *tuj u mërëkulluet*, sh. Bul. për Shk.Shoq. I (1956) 132. Forma më e plotë ruhet pra te Buzuku e te Budi e pjesërisht te Bardhi, po jo më te Bogdani. Një tjetër gjë për të shënuar është kjo, që *mërëkullë*, me gjithë se një shkallë më e vjetër, është sekundare edhe kjo. Trajta e parë gjan të ketë qënë *mërakullë*, në plural me metafoji *mërëkuj*, e *mrekull* duket të jetë kështu një plural i singularizuar. Trajta me *-a* dëshmohej në disa vise: Bardhi përveç formave me *-e*-ka Nugare *Mrrakull*, Nugator *Mrrakullues*, Nugari *Me mrrakulluem*; dhe Miklosichi *mërakull*, e Gazulli *mbrakulli* "gumçi, hokë, fjalë gazi", *me mbrakullue* "me folë fjalë gazi": *mos mbrakullo, e mbrakullues, -e* "çudënar, -e, gaztuer gaztore". Kështu pra ky emër si fjalë kishe na paraqitet me metafoji të kryer, si fjalë profane ruan formën origjinale, sh. Li.Posn. VIII 119.

mti m. "tundësi ku rrahin qumësht". G.Meyeri 295 e jep me trajtat *muti pëti* dhe gjen aty refleksin e serbork. *metem* "tund qumështin për të nxjerrë gjalpë" ose të serbokr. *mutiti* "me turbullue, me përzie", zgjeruar në shqipen me sufiksin latin *-inum*. Selishçevi s'e shënon ndër huazimet sillave të shqipes. Skoku (Jugosl. Enciklopedija I 162) i mbahet spjegimit të dytë të G.Meyerit.

Fjalë që paraqitet me një larmi trajtash: *mti mëti muti pti pëti, bëti buti buti, tpi*, te Nopesa (f.101) *tpi* "tundës, dybek ku rrahin qumështin"; dhe Cordignano² 753 te *zangola*; ka edhe forma me *f*, te Gazulli *feti*, në Lumë *fti* (Mann). Kësaj forme të gegërishtes i përgjigjet prej toskërishtes *fti-ri* i Pogradecit. Të gjitha këto piquen te *ti-ni* m. që përdor Shkodra e që e ka dhe Bashkimi e Godini 87 (te *Butterfass*). Kjo është një me geg. *tinë* tosk. *tirë* f. "kade e madhe ku shtien verë" (sh. këtë fjalë). Trajtat *mëti muti muti* janë përngjitur me *më-*; *pëti pti* ka dalë nga *mëti muti* me zhvillim të një *p*-je si tingull homorganik pas *m*-së, për *pti* khs. *ptër* pranë *tër*, sh.

dhe Xhuvani-Çabej Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 80 ; *tpi* nga *pti* me metatezë Te *muti* nga *mëti* ka një labializim të *ë*-së në silabë paratheksore ; te *buti* një ndikim të *but-it*.

mu mù "bash, pikërisht ; *mun munë* "gjer, deri". Te G.Meyeri 28⁸ ka mbetur e paspieguar. Kamarda I 311 e afron me *me*. I pamundur krahasimi me mbaresën e dativit plural në got. *naht-im*, lit.*naht-ims*, sllav, e vj. kish-tare *nostomL*, që bën Treimer, Ethnogenese der Slawen (1954) 3.

Fjalë e mbarë gjuhës. Për mënyrën e përdorimit sh. sidomos Pedersen 164, Lambertz 127. Nuk duhet të jetë një fjalë e vjetër : u mungon kolonive, e nga autorët e Veriut e ka sëpari Bogdani. Nuk është gjë tjetër veçse *më* "më shumë" përdorur në proklisë, që si e tillë, me errësim të *ë*-së në *u*, u ndrua në *mu* : Kështu një shprehje si *më në fund* dha *mu në fund*, me aglutinim *munë fund*, *mun fund*; gegërisht *mun* dha *mù*. Nga *mu në munë*, me një zberthim e një lënie jashtë të prepozicionit të dytë *në*, u arrit në *mu*, Edhe këtu një fjalë formuar brenda fjalisë.

mug m. mugë f. "gjysmëerrësira e mbrëmjes dhe e agimit" ; *muget* "erret, ngryset" ; *mugyt* "errët, ngryset" ; *mugëll* "marrtas, trubull", *mugëllon* "mugët" ; *hana mugëllonte* "nuk ndritte mirë, se e kishin zënë retë" ; *po mugëllonin malet* "sapo nisnin të shquanin aty ndaj agimit" ; *jam mugullue sÿsh* "jam lbyrë" ; *mugësi f.* "të mugëtit" ; *muzg m.* "mugu, të mugëtit" ; *muzget* "muget, mugëllon" *muzgëtinë f.* "të mugët, mugë-sirë, mot i vrerët". Fjalë me etimologji të pavendosur mirë. I padis-kutuëshëm afrimi me gr. *μυχός* "këndi më i brendshëm, më i fshehtë" te Kamarda I 131. G.Meyeri e jep në dy vise të Fjalorit të tij : f.272v. bashkë me *mëngoj* "ngrihem heret, me natë; nxitoj" e me *mëngjës*, sjell dhe *mugë-sirë* ; f.289 ka *muk mugu*, *muget mugët*, *muzg* etj., duke dhënë - me pikëpyetje - një afrim me gr. e re *μούχωμα* "muzgu i mbrëmjes, të ngrysetit". Bariçi (I 104) kërkon te *mug* një bazë **mgh-*, të cilën e krahason me gr. *ἀχλύς* "errësirë". Këtë krahasim e kundërshton me të drejtë, për arsye fonetike, Vasmeri (Studien I 45); duke u nisur nga fakti që kuptimet "errët" e "lagët" ndrohen shpesh në mes të tyre, *mug* ai e përqas me norv. dialektore *muk* "lëng, supë, përzerje", nord, e vj. *mykr* "pleh" etj.

Fjalë e mbarë gjuhës. Forma bazë është *mug*, *muzg* gjan të ketë dalë nga *mugzë*, formë që ekziston me të vërtetë, si *mugzë*, pas Gazullit në Malsi të Madhe ; sekundare, me epentezë popullore të një -n-je, është edhe *mbë të mungullumit* te Kristoforidhi (Gjaja e Malsorëvet, Kop. letrar III 12). Kuptimi bazë është "errësirë", se edhe *muzgë* "baltë" (te Godini "Morast") mund të spiegethet nga ai kuptim i parmë. Atëhere fjala shqipe muud të jetë e afër me arm. *mux* "tym", irl. e vj. *mūch* kymr. *moged* "tym", angl. *smoke* "tym" etj. Baza e fjalës shqipe afërsisht *mug-* ose **smug-*, refleks me vokalizëm të reduktuar (-u-)të rrënjës indoeur. *(s)-*meukh-*, *(s)-*meūg-*, *(s)-*meugh-* "tym". Sh. për këtë rrënjë Pedersen Kelt. Gram. I 122, Walde-Pokorny II 688v., Pokorny I 971. Trajtat e zgjeruara me -ull, si *mugël* *mugëllon*, *të mungullumit*, te N.Frashëri (Ist. e Skënd. 68) *mugullirë* "muzgu i mbrëmjes", shkojnë paralele me trajtat më -ull të ag-ut, si *agull*, *agullim*, *agullue*, khs. dhe *vagëlluar*.- Trajta *muket* "muget" e tosk. jugore të Lunxhërisë duket të jetë trajtë sekundare, me shtrirje analogjike të guturalit të shurdhët në pozicion fundor, i rregullt në toskërishten. Kështu edhe Tase ka *në të mukët të ditës*.

mulë f. "mushkë". Fjalë dialektore, e Ljarjes e e Shestanit, edhe e katundeve të Ulqinit kur i grahin mushkës (*mula!*). Del që te Buzuku (XVI/2, Psalm 31,9): *Mos bani porsi kali e porsi mula* "Nolite fieri sicut

equus et mulus." Sot në Shkodër emër familjeje. Prej it. *mula* ose prej serbokr. *mula*. Nuk vjen në vështrim gr. e mesme $\mu\omicron\upsilon\lambda\omicron\varsigma$. Një formë më të vjetër, latine, ruan *myll*-i i shqipes së Greqisë. — Kjo fjalë, bashkë me disa të tjera, si *vjedmis* "mjedis", *vëliz* "lëviz", kanë rëndësi në punë të caktimit të dialektit të Gjon Buzukut e të krahinës nga rridhte.

mund "kam fuqi, zotësi, jam në gjendje", dhe *mundem*; trans. "e vë poshtë, dal fitues", *s'i mund dot këto punë* "s'i kryej dot, s'i byri"; *mundem* "matem me një"; *mund* m. "mundim; haku i fitimit"; *mundje* f. "luftim trup me trup midis dy vetave; të thyerit e armikut"; *mundim* m., i *mundimshëm*; *mundój*, *mundohem*; *mundac* "ai që mundohet shumë e fiton pak"; *mundaq* "ai që mundohet, që punon rëndë"; *mundës* "fitimtar"; *mundësi* f., *mundësisht*; *mundësój* "mundoj, cfilit"; *i mundshëm* "i mundur, që mund të bëhet"; *mundshtoj* "qërtoj me fjalë të forta"; *mundbjerrët*; *mundzi mundzezë*; *muj* "mund"; *mujój* "mund tjetrin me fjalë, ja bedh poshtë të thënat"; *mujshój* "shpërdorj fuqinë time", *mujsh* f. "dhunë, shpërdorim i fuqisë që kam", *mujshár* "që shpërdor fuqinë me përdhunime"; *s'mund* "jam pa qejf", prej këtej (*i*)*sëmunë*, (*i*)*sëmurë* (sh. këtë fjalë). Për format dhe përdorimin e fjalës, sidomos për *mund*-in e paflektuar para një verbi (*s'mund të rrojmë* etj.) sh. Pedersen 165, Gazulli, Fjal. i gju. shqipe; për përdorimin sintaktik sidomos Rohlf's, Omagiu I. Jordan 736. Pas G. Meyerit (f. 291, Alb. Studien III 64,66) *mund*, nga një bazë **mundō*, piqet me got. *mundrei* "qëllim" *mundōn* "me shikue", gjerm. e lartë e vj. *muntar* "i shkathët, i gjallë", lit *mundras mundrūs* "i gjallë". Jokli (Studien 58, Reallex.d. Vorgeschichte I 91) përfshin në këtë grup fjalësh edhe lit. *mandrūs* "i azdisur" e sllav. e vj. kishtarë *modrъ*, "φρόνιμος σοφός" të cilat G. Meyerit ikish lënë jashtë. Me mendimin e tij bashkohen të gjithë; khs. Walde-Pokorny II 271, Bariç I 105, Tagliavini 198, 199, K. Weissgräber, Der Bedeutungswandel des Präterito-Präsens "kann" vom Urgermanisch-Gotischen bis zum Ahd.-Frühmhd. Königsberg, Deu. Forschungen Heft 4, 1929. Sh. dhe Pokorny I 730, Hofmann GEW 189, Vasmer REW II 169.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku e *s'mundë apënë frujt* "et non referunt fructum"; *qi ata qi n nesh duonë me ardhunë tek ju, s'mundnjënë* "ut qui volunt hic transire ad vos, non possunt"; e *mā nukë munda nxirë n shumicet së peshkut* "et iam non valebant illud trahere a multitudine piscium"; *mund* "vincere" me objekt akuzativ, si sot, e me objekt dativi: e *ju të mundëni gjind të madhe e mā të fortë se ju* "et possideritis eas, quae maiores et fortiores vobis sunt"; e *s ashtë kush të mundën vollundetsë sate* "et non est qui possit tuae resistere voluntati"; *qi për fēt mujtinë regjënivet* "qui për fidem vicerunt regna", me -o- përse *aty ne as ndonjë e pakeqe mos u mundnjë* "quia nulla ei nocebit adversitas"; o *i mujtuni Zot* "omnipotens Deus"; *U sos mordja, e mujti të mujtunitë* "Absorta est mors in victoria"; *E n gre bakeqnë, e mundo anëmiknë* "Tolle adversarium, et afflige inimicum"; *përse ata qi me të n gjënuom mundonjënë mishtë e korpit* "ut, qui per abstinentiam macerantur in corpore"; *mundimetë e mënisë sate . . . hiqi n nesh* "et flagella tuae iracundiae . . . averte"; *i shendë Pandeliu Prift e Monduosi për "martir"* (XL/2, Luka 8,14; XLVIII/2, Luka 16,26; LXV=LXXV, Gjoni 26,6; XLVI, Deuteronomi 11, 23; XLVII/2, Ester 13,9; LXXXV/2=CV/2, Hebrejtë 11,33; XLII/2, Oratio supra populum; XXXII, Oratio IV; LXXXIX=CIX, Korintasit I 15, 54; XLVI/2, Ekleziastiku 36,9; XLV a, Oratio 2; XLI/2a, Oratio 2; LXXXVII/2=LXXXVII/2b, Oratio. Bardhi Posse, Valere *Me mujtunë*, f. 216 *Mos të mundofte i mundumi*. Bogdani (I 50. 12; II 55. 17) *lum ai Nierī ai multi me fejnem e nukë*

fëj "Beatus vir, qui potuit transgredi, et non est transgressus"; *E tue mos munjtunë këta me h^{im} ku ish Krishti* "E mon potendo questi entrare, ove era Christo". Nga trajtat e sotme të këtij verbi, *muj munj* nuk duhet të paraqesë diçka të vjetër, po gjan të ketë dalë nga asimilimi i tingujve në një *mundnj*, zgjerim i mund me *-nj*. Poashtu sekunda është *mus* "e mund" te Drizari, formë e re analogjike ashtu si *shkus* për *shkund*, *tus* për *tund* te ky fjalor. Shprehjen "nuk mund" për "jam pa qejf, sëmure" të shqipes e ka dhe rumanishtja (Puscariu EW 1362, Candrea-Densusianu 224, P. Papahagi, XIV. Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig 142 Nr. 214), si e vetmja ndër gjuhët romane, prandaj mund të ketë këtu një ndikim të shqipes mbi atë gjuhë. — Etimologjia e gjertanishme nuk është fort bindëse as nga ana e kuptimit as nga e formës. Për formën do shënuar se *sëmundë sëmurë* dëshmon që *-n-ja* ka qenë qëmoti intervokalike e që pra *-d-ja* fundore te *mund* është një shtesë fonetike, zhvillim i okluzivit sinjë tingull homorganik pas *n-së*. Në këtë vështrim dëshmon dhe rrethana që Budi zakonisht ka *munë* për *mund*, e rrallëherë *mund*; p.sh. (RR 184) *munë marrënë fjalënë e njanit tjetërit, e munë apënë dorënë, . . . e munë bëkonjëne unazënë; mund* p.sh. (DC 181a, 185a) *As me mundinë me qam; Sã smund me kallëzuom*, mbase për punë të numrit të silabave në varg; sh. Bul. për Shk. Shoq. 4 (1952) 36. Në këto rrethana si formë e vjetër e fjalës do të merret një *mun*, kjo si refleks i një baze **munnō*, ku *-nn-* paraqet produktin e asimilimit të dy konsonanteve. Më tej nuk mund të ndiqet me siguri historia e fjalës. Në qoftë se kuptimi bazë është "mundem, jam i fuqishëm; fuqi, fitore", ajo është e afreshme me grupin got. *mag* "mund, mundem", *mahs* gjerm. *Macht* "pushtet, fuqi", sllav, e vj. kishtare *moga* "mund, mundem" *mostb* "pushtet, fuqi", lit. *māgulas* "i shumtë", gr. *μῆχος* dor. *μαχος* "mjete" *μηχανή μάχανά* "mjete, vegël" etj. Duke u nisur nga "mund-i, mundim" si thelb kuptimi, fjalë mund të krahasohet me grupin gr. *μόςος* "mundim, përpjekje" *μογερός* "i mundimshëm, i lodhshëm", *μογέω* "mundohem" *μόχθος* "mundim", let. *smags smags* "i rëndë në peshë", lit. *smagūs* "vëshitirë për të bartur o për të tërhequr". Në rasën e parë një bazë parashqiptare **mēgh-no* **mǫgh-nō* dha në shqipen **mⁿnō* e me zhvillim të nazalit sonant në *un* **munnō* *mun mund*. Në të dytën një *(*s*)*mog-no* dha **monnō*, kjo nëpër **mⁿnō* poashtu **munnō* *mun mund*.

murg mung m. "kallogjer", fem. *murgeshë mungeshë; murgár mungár* m. "murg"; *mungade* f. "kuvend murgjish". G. Meyeri 289 jep vetëm *mungeshë*, dhe këtë, bashkë me *munakeshë* që ka Rossi, e nxjerr nga it. *monaca* + *-eshë*. Jokli përkundrazi (IF 44,39v.) te *murg* (tosk. te Fan Noli *murk*) e te *mungar* sheh një huazim nga lat. *monacus*, me rotacizëm e me sinkopë të vokalit pastheksor në trup të fjalës; *munakeshë mungeshë* e afron në mënyrë të veçantë me retorom. *munissa*, frgj. e vj. *moinesse* "murgeshë" dhe sheh edhe këtu një huazim nga lat. vulgare e njëkohësisht një konkordancë të shqipes me retoromanishten në fushën e gjuhës kishtare.

Trajtat *mung* e *murg* piquen te *munëg*, nga lat. *monachus* ose nga lat. e mesme *monicus*, që rron dhe në gjerm. *Mönch; munëg* e ka në plural Buzuku (XVIII 2a) *O ju gjithë Munëgj e Remita* "Omnes sancti Monachi et Eremitae", sh. Bul. për Shk. Shoq. 1 (1956) 125. Te *munëg* në toskërishten u krye më parë rotacizmi (**murëg*) e pastaj ra *-ë-ja*, ashtu si ra dhe në geg. *mung*. Geg. *mungeshë* është një formim i brendshëm nga *mung*, jo lat. vulgare *monachissa*, sh. Revue de Ling. VII 1 172 v.; tosk. *murgeshë* duket të jetë më e re, mbase formë letrare. Ndërkaq *munakesha* e Rossit, në qoftë se ka ekzistuar vërtet, është it. *monachessa*. — Në truall të shqipes, ashtu si dhe në serbishten mesjetare, kanë konkuruar dy fjalët kishtare, gr. — lat.

monachus e gr. — biz. **καλόγερος**; kështu Bardhi ka *Monachus Këllogjënë* (sh. *kallojër*). Me të parën shqipja afrohet me romanitetin perëndimor, ku rron lat. *monachus* (te Meyer-Lübke REW 5654). Të dyja fjalët rojnë ndërkaq në shqipen edhe jashtë gjuhës kishtare, khs. *munku i grunit* = *=klllogjën* (Fjal. i gju. shqipe). Te *mungade* kemi një zgjerim me *-atë* në trajtën *veriake*, me sonorizim të *t-së* në silabë fundore, khs. *forcade*. — Për *murg* "i shkretë, i mjerë" sh. atë fjalë.

murrë-ri murrâ m. "erë e ftohtë e veriut"; geg. edhe *murlâ murrllâ*. G. Meyeri 42 (te *borë*) e shpie te një bazë latine e rindërtuar **boreānus*, prej *boreas* "erë e veriut", it. *bora*.

Del që te Bardhi: *Aquilo Murrani, veri, Dukagjini, burri, Notus Murrani*; Bogdani (I 38, 29) *murlani* "il libeccio". Puljevski 17 *murani* "veriu". Një bazë latine **boreānus* nuk dëshmohet gjëkund, atje njihet vetëm *boreālis* e *boricus*, sh. Ernout-Meillet 115. Gjan të jetë një me *murrân* "zeshkan" që përdoret në Hot, te Gazulli *murrâk* "i murmë", *murrâsh* etj., e të lidhet kështu me *i murmë*. Erërat e forta, e sidomos ato të veriut, e kanë emrin nganjëherë prej errësirës; khs. *thëllim: thellë*; gr. **καυκίαç** "erë e verilindjes": lat. *caecus*; lat. *aquilo* "erë e veriut", pas Walde-Hofmannit I 60 e afër me *aquilus* "i murmë më të zi". Për sufiks-in *-an*, sot geg. *-â-ani*, tosk. *-ë-ëri* te *murrâ murrë* e te *mullâ mëllë*, sh. Xhuvani-Çabej Prapashitesat 16.

murriz, murriz m. "Crataegus", ku C. oxyacantha e ku C. monogyna (kështu në anët e liqenit të Shkodrës, H. Bertram HD VI 628), sh. dhe Mit-rushi 117 v.; *m.deti, m. i kuq* "Pyracantha coccinea, ushinh". Te Gazulli *murriz* "Prunus spinosa". Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri (f. 92) e çon te një bazë **mburniz-*, duke e afuar me gr. e re **προυνελιά** **ἀμπουρνελιά ἀμπουρνέλο** "murriz" prej lat. *prūnus*, it. *prugnolo*. Ai ndërkaq përmend dhe mendimin e Schuchardit (KZ 20, 250), i cili e afronte fjalën shqipe me it. *marruca* "lloj ferre", rum. *maraciune maracine* "murriz". Këtë etimologji e pranojnë mjaft dijetarë, si Cihacu, Puscariu EW 1025, Jokli IF 36,148. Treimeri (Slavia III 455) sheh te kjo fjalë një kompozit *mollë-drizë*. Në Bul. për Shk. Shoq. I (1956) 140v. shënim kemi kundër-shtuar spjegimin nga lat. *marrucinea*, meqë prej kësaj rrjedh një tjetër fjalë e shqipes, *mërqinjë*.

Kjo shkurre në shumë gjuhë e ka emrin nga gjembat e fortë e të shumë që ka; khs., gjerm. *Hagedorn Weissdorn Schwarzdorn (Dorn* "gjemb"), it. *biancospino*, frgj. *aubépine* etj. Kështu qëndron puna dhe me *murriz murriz*. Kjo fjalë lidhet me *morr*. Një paralelizëm që bie në sy në këtë mes është rum. *paducél* "morr i vogël" e "murriz", në plural *paducéi* "morth", krejt ashtu që shq. *morr: morth: murriz murriz*. Meqë në gjuhët romane lat. *peduculus* "morr" përgjithësisht nuk ka marrë të tilla zhvillime, ka të të gjarë që cmërtimet e rumanishtes të kenë dalë nën ndikim të shqipes. Në këto rrethana te *murriz* ka një mbyllje të *o-së* paratheksore në *u*, si te *kunat, kusar, mull* etj., për të cilën sh. Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1048, Helbig 53v., Jokl LKU 225,274; khs. dhe *kurriz*, te Kurti I² 129 *korriz*. Morfologjikisht *murriz* është një deminutiv me *-zë*, poashtu si rum. *paducél*. Atëhere si bazë e fjalës rezulton një **morr-zë*, zgjerim me *-zë*, sufiks që u ngjitet disa herë dhe mashkulloreve; **morrzë* **mórrzë*: *morrizë murrizë*, khs. *kokërrzë*: *kókrizë*. Ndërkaq fem. *murrizë* që e ka ndër të tjera një të folë arkaik si ata të Kalabrisë (de Rada), mund të jetë trajta origjinale e fjalës e, maskh. *murriz* një inovacion. Inovacioni duket të ketë nisur te plurali më *-a* (*murriza*), që çfaqet në emra të së dyja gjinive, me mbarese që është inderente ndaj ndryshimit të gjinisë, e në analogji me mashku-

Horet më -a (*derra, pleshita* etj.) nga pl. *murriza* të jetë formuar një singular i ri mashkullor. Te *morth* e te *murriz* shohim dy deminutive të ndryshme të *morr-it*. — Sh. dhe *morretra*.

mushkëri mushkëni f. "mëlçi e bardhë". Merret përgjithësisht, që prej Miklosichit (Alb. Forsch. II 549) e G. Meyerit (f. 294) e këtej, si një huazim nga lat. *musculus*; sh. Tagliavini 200.

Ndërsa sot përdoret vetëm për "pulmo, mëlçi e bardhë", dikur duket të ketë qenë përdorur dhe për "iecur, mëlçi e zezë" ose vetëm për atë. Kështu Bardhi ka Iecur *Mushkëni*, Fel fiele *Tambëllthitë e mushkënit*. Dhe në Borgo Erizzo *mushkunia e bardhë* "polmone", *mushkunia e zi* (sic!) "fegato", Tagliavini 200. Kështu edhe Kristoforidhi *mushkëni mushkëri* e jep për "mëlçi", *mushkëni* (*mushkëri*) e bardhë *πνεύμων*, m. e zezë *ἥπαρ*; poashtu dhe Weigandi 59. Duke pasur parasysh dhe formën e fjalës, që është një kolektiv më -(ë)ni -(ë)ri si *shoqëni shoqëri, burri burëri, grani grari* etj., dibr. *mbretënitë* "mbretërit", fjala në këto rrethana duket të ketë qenë dikur një emër përbledhës për "përbrendësat, rropullitë", mbase në fillim për përbrendësat e bagëtisë së therur, në jetën baritore. Specializimi është më i vonë. Një zhvillim paralel i kuptimit vihet re dhe te *mëlçi*. Kështu kjo fjalë dëshmon për ekzistencën e *mushk-ut* në mbarëgjuhën. Mundet që, me reduktimin e *u-së* së pathekse, trajta e parë të ketë qenë **mëshkëni*, e që *mushkëni* t'i detyrohet një regresioni, një kthimi të *ë-së* paratheksore në *u*, në afërsi të një labiali. Sh. *mushk*.

mushkëer mushkëri m. "kotorr i vogël, viç bualli", fem. *mushkëre mushkëre* "kotorre e papjellë". Mungon te G. Meyerit, e ka sëpari Kristoforidhi për Elbasan. Primitivi *mushk* gjan të afrohet me gr. e vj. *μόσχος* "fidan, mugull, njomëz; viç, mëshjtjerrë, mëzore", Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 131, 146. Një *o-je* të greqishtes shqipja edhe në disa të tjera fjalë i përgjigjet me *u*, si te *dukem, gjuhë*. Ndërkaq raporti etimologjik midis dy fjalëve, a afëri gjenetike apo huazim nga njëra anë a nga tjetra, mbetet dorajdorën i pasqaruar. Fjalën greke e lidhin disa me lit. *mazgas* "syth, mugull" e me arm. *mozi* "gjedh i ri, viç" e po sh. tani Pokorny I 750, Fraenkel 426v.

mushllinzë f. "Convolvulus arvensis" te Cordignano, te Godini *mushllizë* "Zaunwicke", edhe te Manni. Etimologjikisht shkon bashkë me *bushllizë* "Convolvulus arvensis" te Fjal. i gjuhës shqipe. Të dy emrat reflektojnë idealisht një **mbësht(ë)llizë* **bësht(ë)llizë*, nga *mbështjell*. Me këtë verb (*shtjell, shtall*) janë formuar në shqipen edhe të tjerat emra të bimës Convolvulus: *pështjellcë pështjellëz* e *gështallë* (sh. te kjo fjalë). Për shpërnguljen e akcentit në silabë të parafundit (**mbështëllizë* nga **bështjëllizë*) khs. *kokrriçë* : *kokërr*, *murriz* : *morr*, *derdhazë*, *këlbazë*. etj.

muz m. "masë drithi, gjashtëdhjetë okë ose një barrë (grurë)". E parregjistruar në burimet e shkruarit, dokumentohet në një kanunore turke të Shkodrës, të vitit 1570, te Omer Lutfi Barkan Kanunlar (1945) 291. Nga lat. *modius* "shinik", që ruhet edhe në greq. e mesme, si *μόδιος μόδι*, te Triandaphyllidis 125. Për punë të vlerës fonetike dyfishe të *vav-it* në alfabetin arabo-turk (dhe *u* dhe *o*), fjala e shqipes në parim mund të ishte edhe *moz*. Do të pëlqehet ndërkaq leximi *muz*, me reflektim të *o-së* së shkurtër latine me *u*, si te *shpuzë* "hi i nxehët" nga *spodium*, sh. Revue de Linguistique VII 1 198. Si *kartë* (sh. këtë fjalë), ashtu dhe *muz* sot nuk përdoret më.

Muzakë. Emër i një dere bujare të Shqipërisë në mesjetë, me burim prej krahinës së Oparit. Përmendet sëpari në 1274 (Andreas Musacius), sh. Hopf Chroniques gréco-romanes 300, Acta Albaniae I 318. Historinë

e kësaj dere dhe rrethanat e shtektimit në Itali e përshkruan kronika e Gjon Muzakit e vitit 1510, botuar sëpari te Hopfi. Ruhet ky emër sot te ai i *Myzeqë-së*; emër familjesh *Muzhaqi* ka në katundet Polis e Gurakuq të Elbasanit, këtu dhe toponimi *Guri Muzaqit*. Në Çamëri katund *Muzhaka* afër Filatit. Në Itali ka *Muzaki* te Arbëreshët e Molizës (Lambertz IJ II 6) e në Siqeli. Si një emër që ka dalë prej Opari, *Muzaki* është një *me mëzak* "viç" që përdoret n'atë krahinë, sh. Li. Posn. VIII 104. E ka dhe Lunxhëria e Bregu i Detit për "viç (a viçe) motak gjer dyvjeçar" (M. Totoni). Kjo është një formë dialektore e *mëzat-it*, e lidhet në analizë të fundit me *mëz, mëzej mëzoj*. *Muzaki*, në thelb një ofiq, është një nga ato emra vetiake që rrjedhin nga emra kafshësh, kriter emërimi i shpesh të në gjuhën shqipe.

myshk m. "Muscus". Mungon te G. Meyeri. Nga lat. *muscus*, për përhapjen e së cilës në gjuhët romane sh. Meyer-Lübke REW 5774. Edhe shqipja dëshmon, bashkë me gjuhët romane, për *u-në* e gjatë të fjalës latine; sh. për këtë dhe Ernout-Meillet 646. Rum. *muschiu*, arom. *musclu* nga deminutivi **musculus*, Puççariu EW 1139. Për gr. e re *μούσκούλο* sh. G. Meyer Ngri. Studien III 46. Trajta *myshnje* ka ndruar *-k-në* fundore me sufiks *-nje*, i shpesh të në emra bimësh e drurësh, ndër të tjera edhe në *leshnje* "myshk" (Delvinë).

R é s u m é

ETUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XIV

magár margác magjâr m. "âne". C'est un composé ma-gar, apparenté à l'intérieur de l'albanais à gaç (*gar-g) "anon", et à ager "âne" et gare "ânesse" (Gj. Buzuku), racine albanaise *gar, pour laquelle v. ager. Les mots serbo-cr. magarac magarica magare bulg. magare roum. magar proviennent par conséquent de l'albanais.

mahajër f. "friche". Selon N. Jokl du reflet dalmatique de lat. maiarium "friche, jachère". A cette même source semble remonter majere-t spl. "terreni a scala o pensili".

maj m. "gros marteau, maillet de fer; gros maillet de bois des bâtiers; maillet, fouleur". Un des mots albanais d'origine incertaine, latine (malleus "maillet marteau") ou italienne (maglio "mail, massue, battoir").

malcój "irriter" (une plaie), malchet plaga. Plutôt que le reflet d'un lat. *malitiare, base reconstruite et invraisemblable, identique à mëlcoj ëmbëlsoj "rendre doux, adoucir", employé comme un terme euphémistique dans ce même sens.

mallotë "gros manteau de laine des montagnards de l'Albanie du Nord". Remonte, en dernière analyse, au gr. *μηλωτή* "pelisse", mais par voie indirecte, de l'arabe malluta, à travers le turc.

Pour *man* m. "mûrier, mûre" la parenté avec le *μαντεία* mantia du dace est établie, mais on y doit ajouter, comme un mot relique de "l'illyrien des Alpes", *mani* "framboise" de la Valteline. L'alb. *man mën* d'une base *mand-, celle-ci peut-être d'un *mant-

mang m. "petit d'animal", seulement dans le Missel de Gj. Buzuku *mangu* i sutësë "hinnuloque cervorum". Du groupe de l'arm. *manr* "mince, délicat" "petit" *manuk* "enfant, garçon", gr. *homér. μανός* „clair-semé, mou." Si la restitution *μάνυ πικρόν 'Αθαμάνες* en *μικρόν* est

juste, dans μάγνυ: mangu on a à fare avec une concordance entre l'ancien épirote et l'albanais.

mangulój "caresser, cajoler" ne peut être séparé du roum. măgulesc même sens, qu'on fait dériver du grec.

margjënier m. "saillie d'un rocher qui sert d'abri". Dérivé d'un *margjën, et ce dernier mot du lat. (balkanique) margine(m) "bord, marge", mot qui survit en outre en roumain et en dalmate.

marmur m. "marbre", attesté dans les anciens monuments littéraires aussi bien qu'en albanais d'Italie, remonte au lat. marmor, qu'on doit admettre également pour le latin balkanique.

mastël m. "petit tonneau, petit baquet ou cuveau", chez Gj. Buzuku "modius". Du vén. mastelo plutôt que de l'it. mastello. A regrouper ici, en outre, marcé "petite cuve" de l'albanais de Dalmatie, cité chez M. C. Tagliavini p. 183.

mashën f. "station de brebis; fenil; étable de bétail". Semble être le pluriel singularisé d'un *mashë, et cette forme le reflet du lat. massa "masse, pâte", avec le sens qu'on trouve dans l'it. massa "bien, terre, bien-fonds" masseria "ferme", etc.

mashterk m., mashtër f. "écuelle profonde de bois". De l'all. Maser, anc. haut all. masar "bois madré, madruré; coupe en bois madré", à travers le serbo-cr. masur "écuelle de bois".

mat "bord, rive, rivage, côte, plage", nom aussi d'une rivière (Mat, et de la région respective Matja). Ni apparenté au lat. mons, ni emprunté au gr. ἄμυθος "sablé", mais le proche parent de l'irl. math "sable". A confronter aussi Matoas, l'ancien nom du Danube.

matarój "arranger, disposer". Comme l'a bien démontré N. Jokl, c'est un verbe intensif (ou itératif), un élargissement en -ëroj de mat "mesurer".

mbarështój "régler, administrer, arranger". Un verbe dénominal de mbarë "propice, avec succès," formé par analogie avec l'opposé mbrapshtoj "renverser, pervertir".

mbars "féconder, engrosser, rendre pleine". Apparenté, comme on sait, à barrë "poids, charge de cheval; grossesse", à mbarë mentionné ci-dessus, à bark "ventre", bie "porter, amener, conduire", bir "fils", etc. Le verbe mbars se rattache en outre à βαρδῆν βιάζεσθαι γυναίκας Ἀμβροκῶται tout aussi comme l'adjectif mbarsë d'après N. Jokl à equa bardia ἰππῆς φορᾶς, glosse probablement d'origine illyrienne.

mbath "chausser, mettre (des chaussures), ferrer un cheval", mbathem "se chausser", zbath "ôter des souliers, déchausser" z bathem "se déchausser". Pas un emprunt au lat. bassus (frç. bas esp. bajos, etc.), mais un mot des sources autochtones. La forme première en est bath, et son premier sens "déchausser". Aussi le mot est du groupe de lit. bāsas let. bass sl. bos arm. bok, all. barfuss "nu-pieds".

mbërthėj "agrafer, boutonner; clouer" mberthehem "se boutonner; en venir aux mains", zbërthėj "déboutonner". C'est un élargissement de mbath, mentionné tout à l'heure; forme à -a- réduit en -ë- en syllabe atone et développement d'un r inorganique.

mbërij mbrij mërij "arriver; rejoindre, atteindre". Pas une variante du synonyme arrij, mais plutôt un postverbal de mbar "porter, transporter, traîner", et comme tel le proche parent de mbaroj "achever, finir".

mbiatu "aussitôt, sur-le-champ". Mot de l'albanais de Calabre, qui n'a rien à faire avec l'it. atto. Etant donné la forme mbiattë également, ce mot résulte être une lexicalisation de mbi atë "sur cela". A confronter pour le sens les fr. sur çela, là-dessus, l'angl. thereupon, et aussi l'all. indes.

mësýj "assaillir, attaquer, se dresser", dans le dictionnaire de F. Rossi "adocchiare". Appartient, comme une forme analysable en *më-syj*, à *sy* "oeil", cf. le *fr.* avoir en vue, l'*all.* ins Auge fassen. Lexicalisation d'une liaison grammaticale, comme *bzâj*, *vrej*. A cf. surtout le roum. *ochiesc* "viser": *ochiu* "oeil".

mëshere f. "petit morceau rond de fromage", aussi *mëshyer*. Semble être le même que *mëshërier* *mëshirë* "pitié, compassion, miséricorde", avec un passage sémantique de l'abstrait au concret, à travers l'échelle *miséricorde*: *aupône*: pain: pain de fromage. Tout aussi *meshë* "messe" désigne une petite miché de pain, et *lëmoshtra* fpl. "aupônes" aussi les miettes de pain.

mështekër **mështekën** f. "Betulla verrucosa". Du gr. anc. (δένδρον) **μαστίχινον** "(arbre) résineux". Le nom roumain de cet arbre, *măsteacăn*, est probablement d'origine albanaise.

mëtrik m. "colique du bétail", *mertik* "maladie des animaux femelles qui ont mis bas", d'où *mertik* "Ricinus communis" et *mëtrik* "Vinca minor". Du lat. *matrix* matrice "matrice". Plus exactement, ou l'aroum. *mătrică*, sard. *matrika* *madrìgga*, d' un lat. (balkanique) **matrica*. Le développement sémantique du mot en albanais coïncide dans les détails avec ce qui a eu lieu en roumain.

milák m. "levraut; enfant au dessous de deux ans". A rapprocher du gr. μέλαξ "jenne homme, page" μέλακες νεώτεροι dans Hésyche, mot qui du reste est considéré d'origine obscure.

mitë f. "rejeton qui pousse autour du tronc d'un arbre coupé", *mitëz* "biche", en albanais d'Italie *kaca-mitë* même sens, à rapprocher du gr. **μίτυλος** "sans cornes" (dit des chèvres) attesté dans Théocrite. Il peut s'agir d'un élément préalbanais (illyrien) en dorien.

Mitër, aussi *Bitër*, ce dernier aussi nom de famille, *shëmitër* "octobre". Du gr. Δημήτριος, passé pendant l'époque byzantine en albanais comme dans les autres langues balkaniques. Cf. ci-dessus *Mëhill*.

mizón "il tombe de la neige fine". Un verbe dénominal de *mizë* "mouche". Cf. pour le sens, entre autres, l'esp. *moscas blancas* "flocons de neige".

mjedhër **mjedër** f. "framboise", d'après une règle phonétique de l'albanais présuppose forme de base un **mjerdhë*, ceci un **mer-da*, proche parent du mot celtique moyen irl. *merenn* *cymr.* *merwydden* "mûre", où on fait entrer aussi gr. **μόρον** lat. *morum*; ou bien d'un autre mot celtique, irl. *smër* *cymr.* *mwyar* "mûre de ronce" *corn.* *moyr-bren* *bret.* *mouar* "morus".

mjegull **mjergull** f. "brouillard". Des étymologies proposées jusque-là, seul se maintient le rapprochement avec le gr. **ὀμίχλη**, sl. *mъgla*, lit. *miqlà*. Les difficultés phonétiques sont bien surmontables.

mjetë f. "laine courte, déchets de laine", mot commun à tous les dialectes, y compris ceux de Grèce. Un composé à préfixe *m-*, un postverbal de *jes* *jeta* "rester". Le synonyme *metza* par contre provient de la forme composée de *jes*, à savoir de *mbes* *mbeta*.

mlysh "Esox lucius, brochet". Du lat. *lūcius*, qui d'après sa présence en grec moderne aussi, peut être invoqué également pour le latin balkanique. Pour le sens "stupide, idiot" cf. l'*all.* *Stockfisch*.

mllef "courroux, rancune". Ce mot du guègue septentrional n'est qu'une forme dialectale de *mëllë* *mullâ*, mentionné ci-dessus. Issu de *mlle* *mlleni*, le mot a développé un -h pour éliminer le hiatus, et ce son s'est labialisé régulièrement en -f en syllabe finale.

morth "engelures". C'est le diminutif de *morr* "pou", tout aussi comme le nom de cette même maladie en roumain, *păducei*, est le pluriel de *păducel* "petit pou". V. aussi *murriz*.

mos, négation prohibitive "ne pas", et interrogative "nonne, est-ce que ne". Appartient, comme on sait déjà depuis F. Bopp, au groupe du sanscr. má, gr. μή, arm. mi, etc. La difficulté à expliquer le s final de mos en face de mo qui existe également, s'écarte si on conçoit ce s comme une addition ultérieure. Cet élément s'est agglutiné à mo dans des propositions interrogatives négatives, type mo s do vajzën e mbretit? "ne veux-tu pa la fille du roi?"

moshë f. "âge". La parenté de ce mot, à l'intérieur de la langue, avec mot "année, temps" et mas mat "mesurer" masë "mesure; génération", et dans le cadre indo-européen avec le lit. mētas "temps, année", lat mētiur "mesurer, évaluer, estimer; parcourir", etc., depuis G. Meyer et N. Jokl est établie. De l'albanais provient le roum. moș "vieillard, grand-père", fém. moșă "vieille femme, grand-mère". A remarquer que mot est employé par Gj. Buzuku aussi au sens de l'âge, ce qui signifie que moshë n'est qu'une forme élargie de mot.

moshtrë f. "monstre". Du lat. mōnstrum. Emprunt du bas-latin, comme le démontre le reflet inaltéré de l'o.

mpij pij mbij "engourdir", mpihem pihem mbihem "s'engourdir". La forme de base pij, reflétant en dernière analyse un *paginio: *pēinj, se présente comme le proche parent de gr. πάγος "glaçon, gelée" lat, pango "ficher, enfoncer, planter, établir solidement, conclure", all. Fach, etc. Le sens originnaire de "raider" s'est conservé dans des tournures comme fmi i pīm zanash "enfant maigre, défait", sens propre "enfant raidi par les fées".

mrekull m. mrekullí f. "miracle, merveille", du lat. miraculum. La forme première semble avoir été *mērakullë, pl. mērékuj, et l'actuel mrekull un pluriel singularisé. Aussi F. Blanchus atteste Nugae Mrrakullí, Nugator Mrrakullues, Nugari Me mrrakulluem, et récemment Gazulli mrrakullí "raillerie".

mti "baratte". Ce mot, qui se présente sous des formes très variées, comme mtí, mētí, ptí, ftí, butí, tpi, a l'intérieur de l'albanais se rapproche de tinë tirë "cave à vin, bachon".

mu mù "précisément, au juste, jusqu'à, tant que". Le même mot que më "plus, davantage", ayant changé son ë en u (ou) en position proclitique, më në fund "en dernier lieu" donnant mu në fund. De mu në par agglutination mun, d'où le guègue mù.

mug m., mugë f. "crépuscule, nuit tombante", muget "le crépuscule commence, la nuit tombe", muzg, de mugzë, mugëz. Premier sens "obscurité". Probablement du groupe arm. mux "fumée", anc. irl. mūch, brct. moged, angl. smoke même sens, etc.

mulë f. "mule, mulet". Mot dialectal de la région d'Ulqin (Dulcigno), de l'it. mula ou du serbo-cr. mula, tandis que myll de l'albanais de Grèce continue le lat. mūlus. Employé aussi par Gj. Buzuku, mulë peut servir d'indice, avec quelques autres mots, pour déterminer le dialecte et l'origine de cet auteur.

mund "pouvoir; vaincre"; s'mund "je suis indisposé", mundem "pouvoir, lutter", mundó j "tourmenter, torturer; châtier", mundim m. "peine, tourment", doit être séparé du groupe de got. mundrei "but", vieux sl. modru "sage", etc. sëmunë sëmure "malade", sens propre "impuissant", indique que la forme originnaire est mun, et que -d n'est qu'un phénomène purement phonétique. La forme de base *munnō appartient au groupe de got. mag "pouvoir", all. Macht, vieux sl. mogu, etc.; ou à celui de gr. μόγος "travail pénible, effort, souffrance" μογεῖν "faire effort, souffrir" lett. smags smagrs "lourd, pesant" lit. smagus "lourd à porter ou à tirer".

murg mung m. "moine", murgeshë mungeshë f. "moinesse". *Forme de base munëg, chez Gj. Buzuku Munëgj e Remita "Monachi et Eremitae". Du lat. monachus. Le fém. mungeshë est une formation interne, nos pas le lat. vulgaire monachissa, et encore plus récent est le tosque murgeshë. Une telle formation est en outre mungade "cloître, couvent". Dans le domaine de l'albanais comme dans celui du serbe médiéval, le lat. monachus a rivalisé avec καλόγερος de l'église byzantine, avec le résultat que tous les deux termes subsistent jusqu'à ce jour.*

murrë murrâ, murrâ "vent du nord". Non pas d'un lat. reconstruit *boreanus, mais identique au fond à murrân, murrák, murrâsh, i murmë, etc., tous mots qui désignent des couleurs obscures. La dénomination des vents forts, surtout de ceux du nord, d'après l'idée de l'obscur, est fréquente, cf. entre autre l'alb. thëllim : i thellë "profond, sombre, obscur".

murriz murriz m. "Crataegus, aubépine". N'est qu'un dérivé de murr "pou" en tant que "épine, épineux, piquant", tout aussi comme le roum. păducel "aubépine", au sens propre "petit pou", qui probablement s'est formé sur le modèle albanais; v. aussi morth.

mushkëri mushkëni f. "poumon", semble avoir désigné jadis aussi, ou exclusivement, le foie, et originellement les viscères, les entrailles du bétail abattu. La morphologie du mot indique une base mushk, qu'on renvoie généralement au lat. musc(u)lus.

mushkëer "buffletin, jeune buffle", fém. mushkore. Semble se rapprocher du gr. μόσχος "petit d'un animal, veau, génisse", mais pourtant le genre de l'affinité reste obscure.

mushllinzë f. "Convolvulus arvensis, liseron", aussi bushllizë. Un post-verbal de mbështjell "envelopper".

muz "mesure de céréaux, une charge de cheval (de grain)", attesté dans un document turc de l'année 1570. Du lat. modius "mesure (de capacité pour corps secs), boisseau". La lecture à -u(-ou), muz, est plus vraisemblable que celle à -o-, moz.

Muzaki, nom d'une famille féodale de l'Albanie du moyen-âge, qui survit encore dans les régions centrales du pays comme aussi dans les colonies albanaises d'Italie. Au fond un sobriquet, de mëzak "veau d'un an ou de deux ans", qui est du groupe de mëz "poulain" mëzât "jeune taureau, taurillon".

myshk "Muscus, mousse". Du lat. muscus, qui existe aussi en roumain. myshnje est une forme à suffixe -nje, tout aussi comme leshnje "mousse", de lesh "laine, cheveux".